


NEIL SHEHU

LUFTA ANTIIMPERIALISTE E VLORES E VITIT 1920

949.65

SH 29



949.65

8629

NEIL SHEHU

LUFTA
ANTIIMPERIALISTE E VLORËS
E VITIT 1920

BIBLIOTEKA E RRETHIT
SHKOLLOR
N. 48900

Recension: ...
Heshtenat: ...
Kop. ...
Bibliot. ...

NEIL SHEHU

LUFTA
ANTIIMPERIALISTE E VJORËS
E VITIT 1920

Redaktor: *Jani Toçka*
Reçenzentë: *Viron Koka*
Koli Xoxe
Piktor: *Spiro Kristo*

SHTËPIA BOTËSE "8 Nëntori"

«Në këtë Vlorë u ngrit flamuri ynë kombëtar më 1912, në këtë Vlorë u zhvilluan luftimet më të ashpra më 1920 dhe armiku u hodh në det, në këtë Vlorë heroike, nën kushtrimin e Partisë së lavdishme Komuniste të Shqipërisë krisi rreptë pushka kundër pushtuesve fashistë italianë e gjermanë dhe kundër tradhtarëve. Dhe kjo luftë u zhvillua e furishme, në të katër anët e Shqipërisë, gjer në çlirimin e plotë të Atdheut. Prandaj për të gjithë popullin shqiptar Vlora është bërë simbol i lirisë, simbol i heroizmave, simbol i vendosmërisë dhe i patriotizmit të flaktë».

ENVER HOXHA

PARATHËNIE

Në historinë e Shqipërisë Lufta antiimperialiste e Vlorës e vitit 1920 zë një vend nderi dhe është një epope e ndritur e saj.

Ajo, së bashku me luftërat e tjera heroike, shpuri në kurorëzimin me sukses të të gjitha atyre përpjekjeve të mëdha të atdhetarëve për sigurimin e pavarësisë dhe të tërësisë tokësore të vendit.

Lufta e Vlorës ishte luftë e të gjithë popullit tonë, i cili përqendroi fuqitë dhe energjitë e tij për të shpëtuar Shqipërinë nga kthetrat e armiqve të rrezikshëm, sidomos nga imperializmi italian që kishte pushtuar Vlorën dhe krahina të tjera në truallin tonë amtar.

Në radhë të parë, në këtë luftë merita kryesore i përket fshatarësisë trime të krahinës së Vlorës e të Tepelenës që me burrërinë e saj dhe me atdhedashurinë e kulluar, i zbardhi faqen kombit.

Shqipëria e vitit 1920 pa të luhet në skenën e saj një dramë e madhe dhe një përleshje e a-

shpër me pushtuesit grabitqarë italianë. Në këtë përleshje, Shqipëria e vogël fitoi dhe këtë fitore të merituar ajo e siguroi jo me forcën e vet numerike e ushtarake, por me superioritetin e madh politik e moral. Historia tregon se popujt, sado të vegjël që të jenë, kur kanë të drejtën me vete dhe i dalin zot lirisë e pavarësisë së tyre, kur bashkohen e kur organizohen, janë në gjendje të mposhtin çdo armik.

Historia ka ligjet e saj të paepura. Etnitë dhe popujt nuk mund të zhduken, nuk mund të asimilohen dhe të kolonizohen sipas dëshirave dhe orekseve të më të fuqishmëve. Fakti që shqiptarët ekzistojnë edhe sot e kësaj dite në këtë truall, kanë etninë, gjuhën e kulturën e tyre të lulëzuar, ka theksuar shoku Enver Hoxha, është një dëshmi e pakundërshtueshme që ne jemi e do të mbetemi këtu për jetë dhe nuk ka forcë që të na zhdukë dhe të na asimilojë.

Siç vë në dukje autori i këtij libri, Lufta e Vlorës dha një ndihmesë të rëndësishme në konsolidimin e shtetit të pavarur shqiptar. Ajo vuri në jetë atë aspiratë të madhe popullore dhe atë vendosmëri që u shprehën në mënyrë të koncentruar dhe si një urdhër i prerë në Kongresin e Lushnjës se shqiptarët «nuk do të lejonin të shiteshin si bagëti në pazaret e Evropës» dhe as të cenohej sovraniteti i shtetit të tyre e tërësia tokësore e vendit.

Në trekëndëshin Vlorë — Tepelenë — Himarë, nga fillimi i qershorit e deri më 3 shtator 1920, u zhvillua një kryengritje e fuqishme dhe e organizuar popullore, e cila vuri përpara ushtrinë relativisht të madhe italiane, që kishte zënë vend në fortifikime të betonuara e që ishte e armatosur deri në dhëmbë. Populli i «opingës», siç shkruante Halim Xhelaja në gazetën revo-

lucionare «Liria kombëtare» në mërgim, bëri mrekulli trimërie dhe heroizmi dhe me ca pushkë të vjetra, me sëpata e me hanxharë, me një çikë bukë të misërt në trastë, theu dhe hodhi në det këtë ushtri imperialiste që nuk donte të shkullej nga vendi dhe që, sipas direktivave të Romës, donte ta mbante Shqipërinë me çdo kusht.

Siç përshkruhet në libër, fshatarëve labë në këtë kryengritje, që u zhvillua me beteja të ashpër, të shpejta e të furishme, me përlëshje burrërore dhe emocionuese, u erdhën në ndihmë të gjitha krahinat e vendit. Ato i ndihmuan materialisht dhe moralisht, madje dërguan edhe forca vullnetare që morën pjesë drejtpërdrejt në betejë. Vetë qeveria e Tiranës, e kryesuar nga Sulejman Delvina, ngarkoi atdhetarin Spiro G. Koleka të interesohet për organizimin e ndihmave të armatimeve dhe për zhvillimin e kësaj kryengritjeje. Ajo nuk doli hapur në skenë sepse ruante në dukje neutralitetin, por në fakt luajti një rol me rëndësi dhe u tregua e mençur dhe e vendosur, qoftë në zhvillimin me sukses të luftës, ashtu dhe në marrëveshjet me qeveritarët e Romës, për t'i detyruar ata që ta zbraznin Vlorën dhe të shporreshin nga Shqipëria. Qeveria e Tiranës i pati krahët e ngrohtë, sepse kishte përkrahjen e fuqishme të popullit dhe të elementëve atdhetarë me influencë, si dhe të forcave përparimtare në Evropë dhe në vende të tjera të botës.

Në një kohë kur imperialistët italianë propagandonin në shtypin e tyre se Lufta e Vlorës ishte një «luftë rebelësh» dhe «fisesh të egra», pa ndërjegje kombëtare, që gjoja kryenin mizori kundër ushtarëve italianë, përkundrazi Evropa dhe bota mësuan se ajo ishte luftë e vërtetë çlirimtare e një populli, i cili tashmë kishte

një ndërgjegje kombëtare të formuar, të pjekur, që donte të rronte i lirë dhe që nuk pranonte të kolonizohej nga Italia e nga kushdo tjetër. Vetë forcat përparimtare të Italisë, sidomos proletariati e socialistët italianë, e demaskuan luftën grabitqare që zhvillonte imperializmi italian në Vlorë dhe u solidarizuan plotësisht me popullin shqiptar, që bënte një luftë të drejtë.

Qarqet reaksionare italiane, me gjithë përpjekjet për ta mbajtur Vlorën, nuk ia arritën dot qëllimit. Ato u detyruan të kapitullonin dhe të shtroheshin në tavolinën e bisedimeve me qeverinë e Tiranës. Përfaqësuesit e qeverisë italiane e pranuan tërheqjen e trupave nga Vlora, duke njohur pavarësinë dhe sovranitetin e vendit. Dokumenti i nënshkruar nga të dyja palët, më 2 gusht 1920, kishte dy vula: vulën e fitores së shqiptarëve dhe atë të dështimit të plotë e me turp të imperialistëve italianë.

Në atë kohë, Mussolini, diktatori i ardhshëm fashist, që i kishte vënë qëllim vetes të vinte në fuqi, u përpoq t'i prekte në sedër qarqet reaksionare, prandaj shkroi gjithë zemërim për dështimin italian në Vlorë një artikull të botuar në gazetën «Popolo d'Italia», me titullin «Amarissimo» (Shumë e hidhur), duke kritikuar qeverinë, që gjoja s'qe e zonja të qëndronte e patundur në Vlorë dhe i lejoi ushtritë e saj të hidheshin në det nga disa «rebelë». Ai bënte thirrje për revansh dhe shpresonte që një ditë të projektonte dhe të zbatonte plane grabitqare kundër Shqipërisë, të cilat i realizoi më 7 prill 1939.

Traditat luftarake të Luftës së Vlorës e të luftërave të tjera ishin rrënjosur thellë në popull dhe u ngritën në një shkallë shumë të lartë në Luftën legjendare Antifashiste Nacionalçlirimtare të udhëhequr nga Partia Komuniste me

shokun Enver Hoxha në krye. Në këtë luftë populli ynë, trim e liridashës, i dha grushte dërrmuese regjimit pushtues fashist italian dhe atij nazist. Musolini e të tjerë, në këtë periudhë patën rastin ta njohin edhe më mirë popullin shqiptar dhe patriotizmin e tij, duke konstatuar se kishte edhe më «amarissimo» se më 1920.

Fitorja në Luftën e Vlorës, më 1920, pati një rëndësi të madhe historike. Ajo e shpëtoi Shqipërinë nga kurthet e nga planet vdekjeprurëse të kurdisura kundër saj, nga copëtimi ose nga kolonizimi i plotë. Ajo tregoi se populli, i udhëhequr nga atdhetarët revolucionarë, ishte gjithnjë shtylla e kombit.

Kur populli munda ta bëjë këtë më 1920, në kushtet e varfërisë e të prapambetjes dhe të një rendi ekonomiko-shoqëror të pazhvilluar, pa një udhëheqje të shëndoshë revolucionare, vetëkuptohet se çfarë energjie të fuqishme grumbulloi ai në Luftën Antifashiste Nacionalçlirimtare, të udhëhequr nga Partia Komuniste (sot PPSH) e cila diti ta bashkojë, ta organizojë e ta drejtojë deri në fitoren më të madhe historike, në çlirimin kombëtar e shoqëror.

Lufta e Vlorës pati rëndësi jo vetëm për faktin që i siguroi vendit pavarësinë e tërësisë tokësore, por edhe pse e bëri popullin më të pjekur politikisht e më të ndërgjegjshëm për fatet e kombit. Ajo e bëri atë më të vetëdijsëm jo vetëm për të luftuar armiqtë e jashtëm, por edhe në luftën kundër klasave reaksionare çifligaro-borgjeze, në luftën për çlirimin shoqëror.

Në ditët e sotme prej saj ne nxjerrim një mësim të madh, atë mësim që populli shqiptar ka qenë dhe mbetet gjithnjë i rrethuar nga armiqtë e egër imperialistë dhe shovinistë. Populli ynë as s'e ka pasur dhe as s'e ka zakon të flerë

mbi dafinat e fitoreve, sepse përvoja i ka tre-
guar se kush fle mbi këto dafina zgjohet një
mëngjes papritur me fitore të humbura dhe në
robëri. Kjo s'ka për të ndodhur kurrë në Shqi-
përinë tonë socialiste, ku në fuqi është populli me
Partinë në ballë.

Autori i librit «Lufta antiimperialiste e Vlo-
rës e vitit 1920» Neil Shehu i ka trajtuar drejt
problemet. Ai ka grumbulluar materiale të shu-
mta dokumentare, ka shfrytëzuar burime biblio-
grafike dhe i ka përpunuar ato në dritën e mësi-
meve të Partisë, të shokut Enver Hoxha dhe të
historiografisë sonë. Libri ka interes për lexuesit
dhe do të shërbejë për të njohur edhe më tepër
tradiat e shkëlqyera të popullit tonë, luftërat
e tij heroike për liri e pavarësi, për të mbro-
jtur me gjak e sakrifica trojet tona nga pushtues
të ndryshëm, siç është edhe Lufta e Vlorës e
vitit 1920, për të cilën bëhet fjalë në këtë li-
bër.

VIRON KOKA

Doktor i Shkencave Historike

PUSHTIMI I VLORËS NGA IMPERIALIZMI ITALIAN MË 1914

Më 28 nëntor 1912, pas 500 vjet robërie nën pushtimin osman, populli shqiptar fitoi pavarësinë e vet. Në Vlorë u ngrit flamuri kuq e zi dhe u mbledh Kuvendi Kombëtar me Ismail Qemalin në krye.

Më 3 dhjetor 1912, Turqia, e thyer në të gjitha frontet, u detyrua të kërkonte armëpushim nga aleatët ballkanikë, të cilët i kishin shpallur luftë. Serbia, Mali i Zi dhe Bullgaria i pushuan luftimet, ndërsa Greqia i vazhdoi ato në drejtim të tokave shqiptare, duke bërë masakra të mëdha në popullsinë e pambrojtur.

Më 29 janar 1913, qeveria e Vlorës u bëri thirrje gjithë atdhetarëve shqiptarë të rroknin armët për të mbrojtur e për të çliruar krahinat e pushtuara nga grekët. Lufta filloi pasi ushritë greke kishin zbarkuar në Himarë dhe kishin pushtuar Korçën; mirëpo forcat shqiptare ishin të pakta në numër dhe të paarmatosura dhe kështu grekët pushtuan Ersekën, Leskovikun, Për-

metin, Gjirokastrën, Tepelenën duke arritur deri afër Beratit.

Ndërkohë, në veri ushtritë malazeze po ngushtonin rrethimin e Shkodrës për ta pushtuar. Trupa të tjerë serbë morën Durrësin dhe Elbasanin.

Shpërthimi i Luftës së Parë Botërore më 1914 pati pasoja të rënda për shtetin e pavarur shqiptar ende të pakonsoliduar. Në këto rrethana tepër të rënda, Italia, e cila fillimisht qëndroi jashtë kësaj lufte, i kishte drejtuar sytë te Shqipëria, veçanërisht te Vlora, që zinte një pozitë të rëndësishme strategjike.

Më 30 tetor 1914, Italia pushtoi Sazanin dhe pas dy muajsh, më 25 dhjetor 1914, pas një provokacioni të kurdisur nga qeveria e Romës, Italia pushtoi Vlorën.

Për t'u vendosur në Vlorë Italia pati përkrahjen jo vetëm të pesë Fuqive të Mëdha evropiane ndërluftuese,¹ por edhe të Greqisë, e cila, ashtu si Italia, kishte shpallur «asnjanësinë» në konfliktin botëror. Ato përpiqeshin ta shfrytëzonin këtë konflikt për qëllimet e tyre të njohura ekspansioniste në Shqipëri. Po kështu edhe dy fqinjët e tjerë ballkanikë, Serbia dhe Mali i Zi, kishin të njëjtat synime, por duke qenë në luftë të armatosur me Austro-Hungarinë, nga përfundimi i saj do të varej gjithçka që ato ëndërronin. Si Italia ashtu edhe Greqia përpiqeshin të siguronin në fushën diplomatike përkrahjen e Fuqive të Mëdha për të realizuar jo vetëm pushtimin, por edhe pjesëtimin e tokave shqiptare: Italia Vlorën dhe Greqia Korçën

¹ Pesë fuqitë ndërluftuese imperialiste ishin rreshtuar: nga njëra anë Anglia, Franca dhe Rusia cariste, kurse nga ana tjetër Gjermania dhe Austro-Hungaria.

dhe Gjirokastrën. Në fund të tetorit 1914 qeveria greke dërgoi në Shqipërinë e Jugut reparte të tjera ushtarake.¹

Për pushtimin e Vlorës Italia imperialiste kishte vënë në lëvizje konsullatën e vet, e cila në bashkëpunim me bejlerët dhe me tradhtarët esadistë, kishte ngritur në Vlorë një spital, një shkollë muzike etj. Kishte gjithashtu edhe disa ushtarë kalorës, që ishin pararoja e pushtimit.

«Pushtuesit italianë vunë nën kontrollin dhe në varësinë e tyre të plotë administratën e Vlorës dhe me qëllime demagogjike ulën këtu flamurin turk e në vend të tij ngritën atë shqiptar, përkrah tringjyrëshit italian. Në të njëjtën kohë ata filluan nga arrestimet dhe internimet e patriotëve dhe shumë shpejt, siç shkruhej në letrat që i dërgoheshin atëherë, nga Shqipëria dhe sidomos nga Vlora shtypit shqiptar jashtë vendit, «zunë të thonë që Vlora është e tyrja, zunë ta shikojnë veten si zotërit e vendit»².

Por megjithatë nuk ia arritën qëllimit, pasi populli shqiptar nuk u është përkulur kurrë armiqve.

1. Në dhjetor 1912 — mars 1913 Greqia kishte pushtuar Korçën dhe Gjirokastrën.

2 «Historia e Shqipërisë», vëll. 3, f. 159.

VITET 1915—1919

Shtetet e mëdha imperialiste dhe fqinjët ballkanikë e konsideronin Shqipërinë si plaçkë tregu. Ato synonin ta copëtonin atë midis tyre. Në kushtet që u krijuan me Luftën e Parë Botërore, Shqipëria nuk mundi ta gëzonte pavarësinë e saj të fituar më 28 nëntor 1912, pasi shtetet imperialiste nga një anë shpallnin të drejtat e popullit shqiptar për të qenë shtet i lirë, nga ana tjetër, fshehurazi, bënë pazarllëqet më të turpshme duke e vënë në ankand sipas interesave të tyre. Pazarllëqet midis Italisë dhe tri fuqive të Antantës: Anglisë, Francës dhe Rusisë cariste në kurriz të shtetit shqiptar, të pavarësisë dhe tërësisë së tij tokësore, që kishin nisur me fillimin e Luftës së Parë Botërore, përfunduan në Londër më 26 prill 1915. Përfaqësuesit e këtyre tri fuqive, në bisedimet me përfaqësuesit e borgjezisë italiane, u interesuan që Shqipëria të mos i rezervohet e gjitha Italisë, por Jugu t'i kalonte Greqisë «asnjanëse», kurse Veriu Malit të Zi dhe Serbisë, që luftonin në

anën e tyre. Kështu, pas nëntë muaj pazarllëqesh me të dyja palët ndërluftuese, imperialistët italianë vendosën të delnin nga asnjënjësia, të braktisnin aleancën e vjetër më se tridhjetëvjeçare që kishin lidhur me Gjermaninë dhe me Austro-Hungarinë dhe të hidheshin me fuqitë e Antantës në luftë kundër ish-aleatëve.

Sipas Traktatit të fshehtë të Londrës krahnat, që më 1913 u përfshinë në kufijtë politikë të Shqipërisë, copëtoheshin në mënyrën më barbare. Po sipas pikës 7 të këtij traktati, përfaqësimi i këtij «shteti», në marrëdhëniet e tij me botën e jashtme i ngarkohej Italisë. Kjo donte të thoshte se shteti i ardhshëm shqiptar do të vihej nën protektoratin italian. Këto veprime vërtetonin dhe një herë në mënyrë të përpiktë fjalët e V. I. Leninit që në ato ditë shkruante: «Italia demokratike revolucionare, domethënë borgjeze revolucionare, që flaku zgjedhën e Austrisë, Italia e kohëve të Garibaldit, po shdërrohet përfundimisht përpara syve tanë, në një Itali që shtyp popujt e tjerë... në një Itali me një borgjezi brutale, tmerrësisht reaksionare dhe të ndyrë; së cilës i kullojnë jargë nga kënaqësia se edhe atë e pranuan në ndarjen e presë».¹

Borgjezia italiane synonte ta zgjeronte shtetin e vet përtej kufijve, të vendosej në brigjet e Gadishullit Ballkanik, t'i përdorte vendet e prapambetura të këtij gadishulli si burim lënde të parë për industrinë italiane dhe si treg për shitjen e mallrave të saj, të depërtonte akoma më tej në Lindje, të zgjeronte kolonitë e tjera. Në këtë plan ekspansionist italian Shqipëria zinte një vend të veçantë.

1) «Historia e Shqipërisë», vëll. 3, Tiranë 1984, fq. 161.

Që në fillim të vitit 1918, qeveria e Romës vazhdoi të përgatiste terrenin, që me mbarimin e luftës të vazhdonte të mbante nën pushtimin e saj Vlorën. Më 23 shkurt 1918 ministri i Punëve të Jashtme të Italisë shprehej hapur se interesi i veçantë, që Italia tregonte ndaj problemit shqiptar, lidhej ngushtë si me zotërimin e drejtpërdrejtë e të sigurt të Vlorës dhe të territorit të saj nga ana e Italisë, ashtu dhe me rregullimin e përgjithshëm të Adriatikut.

Me qëllim që të realizonte planet skllavëruese ndaj Shqipërisë me anën e taktikës së saj diplomatike, Roma vazhdoi të rekrutonte njerëz nga radhët e klasave sunduese në Shqipëri, për t'i vënë kundër lëvizjes kombëtare shqiptare. Detyra për propagandimin e kësaj vije politike të Italisë iu ngarkua edhe fletushkës «Kuvendi», e cila filloi të botohej në gjuhën shqipe në Romë qysh në qershor të vitit 1918.

Oreksi për të pushtuar krahina të tjera shqiptare po u rritej imperialistëve italianë. Gjatë muajve shtator-tetor 1918 forcat e tyre të armatosura hynë në Shqipërinë e Mesme. Më 3 tetor 1918 pushtuan Elbasanin dhe po në këtë kohë hynë edhe në Durrës, madje përparuan deri në Shkodër.

Me mbarimin e Luftës së Parë Botërore,¹ kur u pa qartë se Italia nuk po largohej nga zonat e pushtuara, më 28 nëntor 1918, në përvjetorin e 6-të të Shpalljes së Pavarësisë Kombëtare, si në shumë qytete të tjera të vendit, edhe në Vlorë u organizua një miting masiv. Përpara


¹ Lufta e Parë Botërore mbaroi në nëntor 1918. Në këtë luftë morën pjesë 74 milionë ushtarë. Ajo i kushtoi botës 10 milionë të vrarë dhe 20 milionë të plagosur.

popullit folën Avni Rustemi, Jani Minga, dhe atdhetarë të tjerë, të cilët dënuan agresorët e huaj, që kishin pushtuar tokat tona. Me këtë rast, me iniciativën e Avni Rustemit, në Vlorë u ngrit Flamuri Kombëtar, ngritjen e të cilit pushtuesit italianë e kishin ndaluar.

Kjo demonstratë ishte fillimi i rezistencës së popullit shqiptar kundër pushtuesve italianë menjëherë pas mbarimit të Luftës së Parë Botërore.

Në kushtet politike të brendshme dhe ndërkombëtare të mbarimit të Luftës së Parë Botërore, Romës i nevojitej një organ qeveritar shqiptar në përbërje të të cilit të kishte elementë përkrahës të saj. Kështu, më 22 tetor 1918, ministri i Jashtëm i Italisë udhëzonte që të thërriteshin në Romë Turhan Pasha, Myfit bej Libohova etj, të cilët kishin garanci si kandidatë të përshtatshëm për të formuar këtë qeveri kuislinge që do të përfaqësonte si krahinat e veçanta të vendit, ashtu edhe tri fetë e ndryshme që ekzistonin në Shqipëri.

Ndërkaq diplomacia italiane, për qëllimet e veta, hoqi dorë nga formimi i një qeverie shqiptare, duke udhëzuar që të krijohet një këshill apo një komitet shqiptar, i cili nuk do të kryente veprimtari shtetërore të pavarur as brenda vendit e aq më pak jashtë tij. Ky këshill do të ngrihej në Durrës me personalitete nga krahinat e pushtuara nga Italia, me përjashtim të Vlorës dhe të hinterlandit të saj. Qeveria italiane e konsideronte Vlorën dhe krahinën e saj tokë italiane, e cila duhej shkëputur nga pjesa tjetër e vendit. Por që të dyja, d.m.th. edhe qeveria edhe këshilli kombëtar, sipas tyre, duhej të dilnin nga një kongres kombëtar, organizatorë të të cilit u bënë M. Konica, M. Libohova, M. Kruja dhe M. Frashëri.



Kongresi i Durrësit u mbledh më 25 dhjetor 1918. Në të morën pjesë 53 delegatë, përfaqësues të feudalëve dhe të borgjezisë nga pjesa më e madhe e vendit, nën pushtimin italian, me përjashtim të delegatëve të Vlorës.

Kongresi i Durrësit zgjodhi qeverinë me kryeministër Turhan pashë Përmetin dhe me anëtarë Myfit bej Libohovën, Mustafa Krujën dhe shërbëtorë të tjerë të imperializmit italian. Me një përbërje të tillë kjo qeveri hyri shumë shpejt në rrugën e tradhtisë.

Duke u mbështetur në agjentët e saj në përbërje të qeverisë së Durrësit, Roma punonte aktivisht për të siguruar aneksimin e krahinës së Vlorës, ishullin e Sazanit dhe mandatin mbi pjesën tjetër të Shqipërisë.

Ndërkohë pushtuesit italianë vendosën shtettrëthimin në qytetin e Vlorës. Bënin arrestime, vrasje dhe internime të atdhetarëve. Ndaluan qarkullimin e popullsisë nga një krahinë në tjetrën, vendosën censurë etj.

RITJJA E REZISTENCËS SË POPULLIT SHQIPTAR

Më 18 janar 1919 u hap Konferenca e Paqes në Paris për të përfunduar traktatet e paqes me vendet e mundura. Këtë konferencë e organizuan pesë fuqitë e mëdha fituese të Luftës së Parë Botërore: SHBA, Anglia, Franca, Italia dhe Japonia.

«Vëmendja e popullit shqiptar u drejtua në fillim te kjo konferencë me shpresë se në të do të gjenin një zgjidhje të drejtë kërkesat e tij kombëtare. Por këto kërkesa nuk gjetën në Paris asnjë mbështetje. Përkundrazi, të tria fuqitë kryesore fituese të luftës, Franca, Anglia dhe SHBA, e trajtuan problemën shqiptar jo si një problem më vete, por e panë Shqipërinë si një «plackë tregu» për të kënaqur synimet grabitqare të Italisë, të Greqisë e të Jugosllavisë, në përshtatje me planet e tyre të përgjithshme imperialiste».¹

Imperialistët italianë synonin të siguronin pushtimin e Vlorës dhe prektoratit mbi «shtetin

1 «Historia e Shqipërisë», vëll. 3, Tiranë 1964, f. 193

autonom shqiptar», që do të formohej ose në Shqipërinë e Mesme, sikundër ishte parashikuar në Traktatin e Fshehtë të Londrës, ose në kufijtë e vitit 1913, siç e dëshironte ajo.

Këto manovra të imperialistëve italianë dhe pazarllëqet e tjera që bëheshin në kurriz të popullit shqiptar nga Fuqitë e Mëdha, për të kënaqur lakmitë e tyre dhe të shteteve ballkanike, shkaktuan pakënaqësi dhe ngjallën revolta të mëdha kudo në Shqipëri.

Komiteti i Fshehtë i krijuar atje që më 1915, më 7 nëntor 1918 formoi në Shkodër komitetin e ri «Mbrojtja kombëtare e Kosovës»¹.

Programi i këtij komiteti përbëhej nga 4 pika, midis të cilave ishin kërkesat për të pasur një shtet shqiptar të lirë dhe të pavarur. Programi kërkonte gjithashtu që Italia të hiqte dorë nga Vlora dhe ushtria serbe të tërhiqej nga tokat shqiptare që kishte pushtuar.

Në të gjitha qytetet kryesore të vendit klubet dhe shoqëritë atdhetare si «Vllaznia» në Shkodër, «Afërdita» në Elbasan, «Bashkimi» në Berat, «Përparimi» në Korçë si dhe në qytetet Durrës, Gjirokastër e tjera e zgjeruan veprimtarinë e tyre atdhetare kundër planeve të shteteve imperialiste pjesëmarrëse në Konferencën e Paqes së Parisit.

¹ Komiteti «Mbrojtja Kombëtare e Kosovës» ishte organizatë politike me parime demokratike, që synonte të organizonte e të drejtonte luftën e popullit shqiptar të Kosovës për çlirimin kombëtar, kundër sundimit serb. Kryetar i këtij komiteti ka qenë Kadri Prishtina, atdhetar dhe luftëtar i shquar me parime demokratike, një nga organizatorët e Kongresit të Lushnjës dhe ministër i Drejtësisë në përbërjen e qeverisë, që u zgjodh në atë kongres.

Në mars të vitit 1919 në Brataj të Vlorës u krijua shoqëria me emrin «Shtizat e qytetërimit» me kryetar Halim Xhelon. Në këtë shoqëri bënë pjesë Abdurahman Çiraku (Vermik) Hasan Brahimi (Matogjin), Muço Delo, (Tërbaç), Daut Seferi (Vranisht), Nuro Ahmeti (Tërbaç) Xhemil Veli Duka (Vranisht), Brahim Kushta (Dukat) e të tjerë.¹

Mbledhja e parë e kësaj shoqërie u bë në Brataj, ndërsa e dyta në «Rrepet e Ismail Qemalit» ose në «Rrepet e Mesaplikut». Ajo hapi në Brataj një klub patriotik, ku anëtarët e tij mblidheshin çdo muaj. Detyra kryesore e këtij klubi ishte që ta ngrinte popullin në kryengritje të armatosur për çlirimin e Vlorës.

Shoqëria «Shtizat e qytetërimit» më vonë mori emrin «Mbrojtja shkollore» dhe u bë degë kryesore e «Komitetit të fshehtë revolucionar të Vlorës»² dhe forcë e rëndësishme në përgatitjen e kryengritjes së armatosur. Çdo krahinë e Vlorës kishte celulën e vet të lëvizjes, që udhëhiqej nga mësuesit dhe nga atdhetarët. Ata mbanin biseda e konferenca dhe bënë agjitacion në popull duke u shpjeguar fshatarëve planet grabitqare e djallëzore të Italisë.³

Më 7 shtator 1919 shoqëria në fjalë botoi një thirrje drejtuar arsimtarëve të Vlorës, ku midis të tjerave vihej në dukje se ajo kishte për qëllim të përhapte ndjenjat kombëtare në popull, të bënte bashkimin e tij dhe të sillte përparimin.

1 Gazeta «Liria kombëtare» nr. 90, dt. 1.IX.1928, f. 1; AMH VI. Dosje nr. 29.

2 AQSH i RPSSH, FMA, viti 1919; Halim Xhelo — militant dhe ideolog i shquar revolucionar, Tiranë, 1975, f. 159.

3 AQSH i RPSSH, FMA, viti 1919.

Veprimtaria e kësaj shoqërie u shtri jo vetëm në rrethin e Vlorës, por edhe në rrethe të tjera si në Tepelenë, në Gjirokastrë etj. Ajo ngarkoi Halim Xhelon dhe Abdurahman Çirakun që të shkonin në Kurvelesh dhe në Gjirokastrë për t'i bërë të njohur popullit të këtyre krahinave programin e tyre, që ishte dhe programi i kryengritjes. Mbledhja e Kurveleshit u bë në Nivicë.

Në mbledhjen e Gjirokastrës u lidh një marrëveshje, sipas së cilës, në rast lufte, gjirokastritët do të ndihmonin vëllezërit e tyre vlonjatë për të hedhur pushtuesit italianë në det. Veprimtaria e shoqërisë «Mbrojtja shkollore» vazhdoi deri më 2 qershor 1920. Pas kësaj periudhe ajo u shkri me luftën e popullit vlonjat kundër pushtuesve për çlirimin e Vlorës.¹

Në fund të muajit maj 1919, kur atdhetarët shqiptarë po intensifikonin punën për përgatitjen e popullit shqiptar në luftën për çlirimin e Vlorës, në kundërshtim me interesat kombëtare doli grupi që bënte shumicën e vijës proitaliane në qeverinë e Durrësit si: Myfit Libohova, Turhan Pasha, Mustafa Kruja, Mehdi Frashëri e të tjerë. Këta kërkonin që Italisë t'i bëheshin lëshime në dëm të interesave të popullit shqiptar. Ata propozuan që në rast se qeveria e Romës hiqte dorë nga kërkesa për të siguruar sovranitetin mbi Vlorë dhe mbi krahinën e saj dhe garantonte tërësinë tokësore të Shqipërisë të caktuar në vendimet e Konferencës së Londrës dhe të protokollit të Firences, t'i njiheshin Italisë interesat e saj strategjike dhe detare në krahinën e Vlorës. Ata kërkonin që Italisë t'i lihej pushtimi ushtarak i Sazanit, i Karaburunit dhe i Zvërrnecit dhe t'i lejohej të ndërtonte një bazë

¹ AMH, VI, «Liria kombëtare», 28.XI.1930.

detare në gjirin e Vlorës, në Pashaliman. Këta tradhtarë pranonin kështu jo vetëm «ekzistencën italiane», por shkonin edhe më tutje, duke shprehur dëshirën që në fronin shqiptar të vinte një princ nga dera mbretërore italiane e Savojës.

Për të realizuar kërkesat e saj, në Konferencën e Paqes në Paris (janar 1919-janar 1920), qeveria e Romës bëri ç'ishte e mundur për të tërhequr sa më shumë përkrahës rreth vetes. Përkërisht për këtë qëllim ajo ra në marrëveshje me Greqinë. Bisedimet midis ministrit të Jash-tëm italian Titonit dhe Venizellosit përfunduan më 29 korrik 1919 me një marrëveshje të fshehtë.¹

Në bazë të kësaj marrëveshjeje Italia angazhohej t'i jepte Greqisë mbështetjen e saj për aneksimin e dy krahinave të Shqipërisë së Jugut. Nga ana e saj, Greqia do ta përkrahte kërkesën e imperialistëve italianë për të siguruar mandatin mbi shtetin shqiptar dhe për ta aneksuar Vlorën së bashku me një territor që Italia do ta quante të nevojshëm për mbrojtjen e kësaj baze të rëndësishme strategjike detare. Greqia, nga ana tjetër, prante t'i lëshonte Italisë për 50 vjet një pjesë të skelës shqiptare të Sarandës dhe të ruante asnjësinë e kanalit të Korfuzit.

Për të realizuar qëllimet e saj kolonialiste, Italia imperialiste i paraqiti kërkesa të tjera qeverisë tradhtarë të Durrësit, siç ishin edhe këto: në juridiksionin e administrimit të vendit të pranohej që Vlora të ishte nën drejtimin e pushtesve italianë; në administratën shqiptare të hynin «këshilltarë» italianë; organet gjyqësore të vareshin nga gjykata ushtarake italiane; mësimi i gjuhës italiane të ishte i detyrueshëm në

¹ Historia e Shqipërisë, vëll. 3, Tiranë, 1974, f. 196.

shkollat e mesme; xhandarmëria dhe ushtria të organizoheshin dhe të ishin nën drejtimin e pushtuesve; pranë Qeverisë së Përkohshme të Durrësit do të qëndronte një komisar i lartë italian.¹

Marrëveshja Titoni-Venizellos dhe kapitullimi i qeverisë së Durrësit ngjallën një valë të re zemërimi në mbarë popullin shqiptar. Organizatat dhe shoqëritë atdhetare lëshuan kushtrimin: «Atdheu në rrezik» dhe i bënë thirrje popullit të ngrihej, të rrëmbente armët dhe të delte në fushën e nderit për të mbrojtur vatanin. Në qytete të ndryshme u zhvilluan mitingje të mëdha proteste. Kështu, p.sh., në qytetin e Beratit, shoqëria atdhetare «Bashkimi», e krijuar në shkurt të vitit 1919, organizoi një miting me pjesëmarrjen e 6000 vetave, të cilët kërkonin që Vlora t'i rikthehej Shqipërisë sepse ishte pjesë e truallit të saj dhe pushtuesit italianë të hidheshin në det.

Lëvizja masive u rrit sidomos gjatë gjash-të mujorit të dytë të vitit 1919, kur rreziku i copëtimit të territorit shqiptar u bë më kërcënues. Përsëri në Berat, në Vlorë, në Skrapar, në Lushnjë, në Krujë, në Elbasan, në Gjirokastrë, në Korçë, në Shkodër etj., u organizuan mitingje masive popullore në mbrojtje të truallit amtar.

Më 22 tetor 1919 nga i gjithë populli shqiptar iu drejtua një protestë e ashpër Konferencës së Paqes në Paris, ku midis të tjerash thuhej:

... «Shqiptarët janë të vendosur t'ia arrijnë qëllimit dhe objektivit me përpjekjet dhe mundimet e veta dhe të sigurojnë zhvillimin dhe përparimin kombëtar në fushën e lirisë dhe të

1 AQSH, Fondi i Ministrisë së Punëve të Brendshme, v. 1919.

pavarësisë e jo nëpër duart lakmonjëse të Italisë... Prandaj protestojmë dhe refuzojmë rreptësisht dhe me urrejtje të madhe kërkesën e Italisë për protektorat dhe kontroll mbi Shqipërinë, po ashtu dhe pretendimet dhe kërkesat ilegale të serbëve dhe të grekëve dhe presim nga ideali i drejtësisë që të na i mbrojë të drejtat kombëtare tonat nën garancinë e pavarësisë sonë kombëtare»¹.

Nga manifestimet dhe nga protestat populli kaloi në luftë të armatosur. Filluan ndeshjet me armë midis atdhetarëve shqiptarë dhe ushtrive italiane, si në Pukë, në Mirditë, në Mat etj.

Jehonë të madhe pati në të gjithë Shqipërinë qëndrimi i oficerëve shqiptarë që shërbenin në Tiranë. Ata nuk pranuan të betoheshin dhe të futeshin nën komandën e oficerëve italianë, aq sa paraqitën dhe dorëheqjen. Veprim i tyre atdhetar gjeti përkrahjen e popullsisë së Tiranës.² Xhandarmëria ishte atëherë e vetmja forcë e armatosur vendase, prandaj u bënë të gjitha përpjekjet që ajo të mos futej nën komandën e pushtuesve. Vazhdonin kudo aksionet e armatosura kundër autokolonave ushtarake italiane. Shumë fshatarë nuk i paguanin më taksa administratës shtetërore dhe kur karabinierët italianë shkonin në fshatra, shpesh priteshin me pushkë.

¹ «Dokumente dhe materiale historike nga lufta e popullit shqiptar për liri e demokraci, 1917-1941», Tiranë, 1959, fq. 6-7.

² Gazeta «Liria kombëtare», 1.IX.1928.

DEMONSTRATA ANTIIMPERIALISTE E VLORËS

Si në të gjithë vendin edhe në qytetin e Vlorës rezistenca kundër pushtimit italian po merrte përpjesëtime. Kishte shpërthyer një valë e gjerë protestash, zhvilloheshin mbledhje të fshehta nga atdhetarët për të përgatitur popullin për në demonstratën e 28 nëntorit 1919. Më 24 tetor 1919 organizatat atdhetare (Komiteti Revolucionar i Fshehtë i Vlorës dhe shoqëria «Mbrojtja shkollore»), organizuan në lagjen «Tophana», në shtëpinë e Abaz Mezinit, një mbledhje të fshehtë, ku morën pjesë 30-40 veta. Aty u shfaqën dy propozime për çlirimin e Vlorës. I pari ishte për përdorimin e mjeteve paqësore, me qëllim që të fitohej kohë për të përgatitur opinionin në masat e popullit dhe në rast se nuk arrihej të përdoreshin armët. Grupi i dytë ishte kryesisht për një kryengritje të armatosur. Fitoi propozimi i parë. Nga mbledhja u zgjodh një komision, i cili me shkrim dhe me gojë i shfaqti komandës italiane kërkesën e popullit vlonjat për

heqjen e trupave italiane nga Vlora. Pushtuesit italianë nuk dhanë asnjë përgjigje. Atëherë organizatat atdhetare vlonjate, në fund të tetorit 1919, organizuan në lagjen «Muradie» një mbledhje, ku morën këto vendime:

1. Të përgatiteshin nga vetë vlonjatët 500-600 flamurë për t'i marrë në duar demonstruesit.

2. Të punohej me familjet vlonjate që, më 28 nëntor 1919, ditën e shpalljes së Pavarësisë Kombëtare, të mos vendosej asnjë flamur italian.

3. Të mblidheshin ndihma financiare edhe materiale të tjera për agjitacion e propagandë.

4. U zgjodh një komision i përbërë prej 12 vetash për drejtimin e demonstratës së 28 nëntorit 1919 me kryetar Osman Haxhiun. Beqir Veloja nga Kanina u zgjodh drejtues i djalërisë vlonjate për demonstratën.

Në këtë komision bënë pjesë edhe Jani Minga, Ahmet Durmishi, Hamza Isai, Sali Bedini e të tjerë.¹

Komisioni në fjalë i dërgoi programin e mësipërm prefektit dhe ky ia çoi komandës italiane, e cila nuk e pranoi. Komanda italiane, më 27 nëntor 1919, thirri përfaqësues të demonstratës për t'i trembur, por nuk ia arriti qëllimit.²

Më 28 nëntor 1919, në orën 10⁰⁰ gjithë populli u mbledh në vendin e caktuar, ku folën Osman Haxhiu dhe Jani Minga. Në ballë qëndronin tre djem të veshur me kostume kombëtare, të cilët mbanin në duar flamuj kombëtarë. Në krye të popullit, për të udhëhequr demonstratën, doli vetë Osman Haxhiu. Një oficer italian erdhi për të ndaluar manifestimin, duke

1 AMH, Vlorë, F.L.VI. d.nr.28.

2 AQH i RPSSH, F.L. VI., d. 4, dok. nr. 50926, origjinal.

thënë: «Flamuri kombëtar të mos dalë përjash-ta, festën ta bëni brenda në xhami». Osman Haxhiu iu përgjigj i vendosur: «Ne do të dalim të manifestojmë, flamuri kombëtar do të dalë, ai del në tokën e tij»¹.

«Me të mbaruar fjalën Osman Haxhiu, tregon një veteran, oficeri italian e qëlloi me grusht në gjoks, ndërsa Osmani e qëlloi atë me bastun dhe dha kushtrimin: «O burra djem të sulmojmë armikun»².

Filloi përlëshja fyt më fyt. Dyzet karabinierë e qindra ushtarë armiq, kalorës të armatosur, hidhen për të shpërndarë demonstruesit, por pa ia arritur qëllimit.³

Demonstruesit, pa marrë parasysh dasitë fetare e krahinore, të zënë dorë për dorë, ecnin drejt rrugës ku është sot hotel «Sazani», duke bërtitur: «Poshtë pushtuesit italianë», «Jashtë nga toka jonë», «Rroftë Shqipëria», «Rroftë Vlo-
ra jonë» etj. Ata marshonin me flamurë në duar duke kënduar:

*«Për mëmëdhenë, për mëmëdhenë,
Vraponi burra se s'ka me pritë!
Të vdesim sot me besa-besë,
Pranë flamurit të kuq q'u ngrit» etj.*

Demonstruesit arritën në Sheshin e Flamurit në orën 11⁰⁰. Ngritën flamurin duke kënduar këngë patriotike e duke hedhur valle. Aty qëndruan deri në ora 16. «Në këtë kohë, thotë në

1 AMH, VI, Fl. VI, d. nr. 18.

2 Po aty.

3 AQSH i RPSSH, FMPB. d. nr. 48, original; «Luf-ta e popullit shqiptar për çlirimin kombëtar, 1918-1920», Tiranë, 1975, f. 478.

kujtimet e tij Fuat Çobo, komandanti i ushtrisë italiane dërgoi një grup karabinerësh për të shpërndarë demonstratën».

Por demonstruesit nuk tërhiqeshin. Ata këndonin dhe hidhnin parulla: «Rroftë Vlora shqiptare», «Poshtë barbarët» etj. Atë ditë italianët fyen në mënyrë të shëmtuar krenarinë kombëtare të popullit shqiptar, duke varur flamurin e tij në bisht të një qeni, të cilin e detyronin të kalonte nëpër rrugët e qytetit.

Në mbrojtje të demonstruesve vlonjatë u ngritën dhe protestuan mijëra veta nga të katër anët e vendit. Kështu, p.sh. nga Vlora iu dërgua një telegram proteste Qeverisë së Përkohshme të Durrësit, ku midis të tjerash thuhej: «Populli i Vlorës beson se Qeveria e Përkohshme nuk do të duronte që Vlora, qyteti ku është proklamuar independenca shqiptare, ku është ngritur flamuri për të parën herë pas të madhit Skënderbeg, të jetë nën shkelmin e armikut. Vëllezërit tanë shqiptarë edhe ata besojnë se do të derdhnin pak lot për këtë tokë, për këta vëllezër, të cilët kanë qenë kurdoherë prijës më çdo punë kombëtare dhe do të mos i lënë vëllezërit e tyre të vuajnë dhe të heqin nën zgjedhën e një kombi të huaj».¹

Kundër barbarizmave italiane në Vlorë me 28 nëntor 1919 protestojnë oficerët e batalionit të Lezhës me anën e një kërkesë dërguar Delegacisë së Punëve të Brëndëshme për vënien në vend të nderit të flamurit, të përlyer nga pu-

¹ «Lufta e popullit shqiptar për çlirimin kombëtar» (1918-1920), vëll. I, Tiranë, 1975, f. 480 (letra mban dt. 3 dhjetor 1919, vazhdojnë firmat e komisionit të zgjedhur: Beqir Sulo, Osman Haxhiu, Ymer Radhima, Abaz Mezini etj.

shtuesit italianë duke theksuar se po të mos vihet nderi në vend jemi të shtërnguar me u largue nga detyrat».¹

Kundër qëndrimeve armiqësore të pushtesve italianë ndaj manifestimeve atdhetare të popullit të Vlorës, populli i Shkodrës dhe ai i Korçës protestuan pranë Konferencës së Paqes në Paris.

Ja si shkruhet në një pjesë të protestës së popullit të Korçës: «Italia ndalon popullin e Vlorës të manifestojë dhe të kremtojë përvjetorin e pavarësisë shqiptare të shpallur më 28 Nëntor 1912 nga Ismail bej Vlora. Italia sapo goditi, plagosi dhe mbyti atdhetarët shqiptarë nëpër rrugët e Vlorës dhe shkeli me këmbë flamurin tonë kombëtar, që është simboli më i shenjtë i kombit tonë... Shkelja e flamurit tonë kombëtar shqiptar është shenjë e dukshme e armiqësisë italiane. Mos harroni se goditja që iu dha nderit tonë kombëtar, ka lënduar rëndë zëmrat e popullit shqiptar, i cili është shqetësuar aq shumë nga ngjarjet e fundit të vajtueshme sa që mund të shpërthejë në një revolucion».²

Protesta të ashpra bënë komitetet shqiptare të Kanadasë, të SHBA dhe të Zvicrës, drejtuar kryesisë së dhomës së deputetëve të Italisë në Romë, ku midis të tjerash thuhej: «Veprimet famëkeqe të kryera nga grekët dhe serbët në Shqipëri, u përsëritën nga ushtarët italianë... Kërkoj-

1 «Lufta e popullit shqiptar për çlirimin kombëtar» (1918-1920), vëll. I, Tiranë, 1975, fq. 489. (Kërkesa mban datën 8 dhjetor 1919 dhe është nënshkruar nga 6 kapitenë, 8 togerë e 1 nëntoger).

2 «Lufta e Popullit shqiptar për çlirimin kombëtar 1918-1920», vëll. I, Tiranë, 1975, fq. 495-496.

NË PRAGUN E LUFTËS SË VLORËS

(Nga Kongresi i Lushnjës deri më 4 qershor 1920)

Periudha përgatitore e kryengritjes së armatosur e vitit 1920 zgjati nga Kongresi i Lushnjës dhe deri para fillimit të Luftës së Vlorës, më 4 qershor 1920.

Për realizimin me sukses të kryengritjes së armatosur, shoqëritë atdhetare bënë një punë serioze përgatitore, duke zgjidhur një sërë detyrash aktuale dhe jetike si brenda ashtu dhe jashtë vendit.

Në këtë kohë Italia po mbushte rreth pesë vjet që kishte pushtuar Vlorën. Lufta e Parë Botërore kishte mbi 13 muaj që kishte mbaruar, por Shqipëria vazhdonte të ishte e pushtuar. Në fillim të vitit 1920 në vendin tonë ndodheshin pushtuesit italianë, francezë, serbë e shumë banda greke. Pushtimi i huaj, i pasuar nga botimi i Traktatit të Fshehtë të Londrës i vitit 1915 nga ana e Qeverisë Sovjetike, si dhe pazarllëqet e ndyra

të Fuqive të Mëdha në Konferencën e Paqes në Paris, bënë që të rritet së tepërmi urrejtja e popullit, nevoja e bashkimit dhe e kryengritjes me armë.

Por këtij vrulli luftarak të popullit shqiptar nuk i përgjigjej qeveria e Durrësit, sepse ajo ishte e shitur tek imperialistët italianë.

Orvatjet e para për rrëzimin e kësaj qeverie tradhtare u shfaqën që në maj të vitit 1919, kur u bënë përpjekje për të mbledhur një kuvend nga bashkitë e Elbasanit, të Peqinit, të Kavajës, të Tiranës, të Shijakut dhe të Krujës.¹

Duke folur rreth këtij problemi të rëndësishëm historik, shoku Enver Hoxha ka thënë: «Në të gjitha anët e Shqipërisë kërkonin me këmbëngulje rrëzimin e qeverisë tradhtare proitaliane të Durrësit dhe krijimin e një qeverie antiimperialiste».²

Thirrja e një kongresi të ri kombëtar po bëhej gjithnjë e më e ngutshme. Në këtë Kongres, ku do të përfaqësohej gjithë vendi, në «rrugë legale», do të përmysej qeveria e Durrësit dhe do të zgjidhej një qeveri e re antiitaliane.

Thirrjet për mbledhjen e kongresit filluan të shpërndareshin që më 1 janar 1920, nga një komision organizues me qendër në Lushnjë, i cili ftonte të gjitha krahinat e vendit që të dërgonin nga dy përfaqësues për çdo nënprefekturë. Qeveria e Durrësit dhe pushtuesit italianë bënë provokacione, atentate dhe ndërhyrje të shumta për të penguar mbajtjen e këtij kongresi, por nuk ia arritën qëllimit.

Kongresi Kombëtar u hap në Lushnjë, më

1 «Mbi lëvizjen kombëtare dhe demokratike shqiptare, 1918-1924», Tiranë, 1966, f. 64.

2 Enver Hoxha, Veprat, vëll. 15, f. 39.

21 janar 1920, por meqenëse shumë delegatë, për vështirësi të ndryshme etj. nuk kishin ardhur me kohë, punimet i zhvilloi prej datës 28 deri 31 janar 1920. Morën pjesë mbi 50 përfaqësues nga i gjithë vendi, duke përfshirë edhe Vlorën.

Kongresi i Lushnjës mori tri vendime me rëndësi politike shumë të madhe. Së pari, hodhi poshtë planet e Konferencës së Paqes për copëtimin e Shqipërisë, duke u shprehur për pavarësinë e plotë të Shqipërisë kundër çdo mandati ose protektorati të cilësdo fuqie të huaj.

U hodhën poshtë planet e Konferencës së Parisit për ta vënë shtetin e cunguar shqiptar nën mandatin e një fuqie të huaj, si dhe projektet e qeverisë së Durrësit për të vënë në krye të shtetit shqiptar një princ italian etj.

Vendim tjetër me rëndësi i kongresit ishte miratimi i një akti kushtetues, ku përcaktohej sovraniteti i plotë i shtetit shqiptar, i shprehur nga organet shqiptare, që i zgjodhi vetë kongresi. Ai formoi një Këshillë të Lartë prej 4 vetash, i cili do të përfaqësonte kryetarin e shtetit shqiptar, derisa ky, ashtu si forma e regjimit, do të caktohej përfundimisht nga ana e një asambleje kushtetuese.

Kongresi zgjodhi edhe një Këshill Kombëtar (Senatin) të përbërë nga 37 anëtarë dhe që do të kryente funksionet e parlamentit. Këshilli i Lartë do të ushtronte pushtetin ekzekutiv.

Vendimi i tretë i rëndësishëm i Kongresit të Lushnjës ishte rrezimi i qeverisë së Durrësit, veprimtarinë e së cilës e quajti antikombëtare dhe zgjodhi një qeveri të re të kryesuar nga Sulejman Delvina.

Vendimet e Kongresit të Lushnjës patën rëndësi të madhe për të ardhmen e vendit. Ato përputheshin plotësisht me luftën e popullit shqi-

ptar për lirinë, për pavarësinë dhe për sovranitetin e tij.

Më 19 shkurt 1920 qeveria e re e Sulejman Delvinës i drejtoi një thirrje popullit, ku kërkohej që ai të ishte i bashkuar dhe vigjilent, të luftonte kundër elementëve tradhtarë si Myfit bej Libohova, Fejzi bej Alizoti, Mustafa Kruja, Abaz Kupi e të tjerë, të cilët, me gjithë disfatën që kishin pësuar, kërkonin me çdo kusht të ndiznin vëllavrasjen. Një ditë më vonë kjo qeveri i drejtoi një thirrje tjetër popullit shqiptar, ku kërkohej të lidhej një «besë e përgjithshme» për mbrojtjen e tokave shqiptare.¹

Në Shkodër, në Elbasan, në Tiranë, në Berat dhe në krahina të tjera u krijuan komisione për zbatimin e besës. Përballë këtyre forcave të popullit, më 21 shkurt 1920, qeveria tradhtarë e Durrësit kapitulloi dhe ia dorëzoi administratën e saj qeverisë së re të Tiranës. Më 11 mars 1920 forcat kombëtare morën në dorëzim Shkodrën.

Me miratimin e Qeverisë dhe të Këshillit të Lartë, disa delegatë të kongresit dhe pikërisht ata të Vlorës, të Beratit, të Korçës dhe të Gjirokastrës organizuan një mbledhje të veçantë në Lushnjë për të formuar në fshehtësi një Komitet të Mbrojtjes Kombëtare. U vendos që këto prefektura të dërgonin përfaqësuesit e tyre në Tiranë dhe atje të formonin një qendër të vetme, ku do të merrnin pjesë dhe përfaqësues nga prefektura të tjera. Për t'ia arritur qëllimit u vendos që të organizoheshin Komitete të Mbrojtjes Kombëtare lokale në qendrat kryesore të vendit. Të gjitha veprimet e tyre këto komitete do t'i kombinonin me organet qeveritare lokale dhe me qeverinë qendrore si dhe do të ndihmonin për çlirimin e atdheut. Qeveria dha ndihmesën e vet

¹ F. Veizi, Vepër e cituar, f. 71.

në krijimin dhe në forcimin e këtyre komiteteve. Por duhet theksuar se ish-ministri i Punëve të Brendshme, Ahmet Zogu, luftoi me të gjitha forcat për të sabotuar Komitetet e Mbrojtjes Kombëtare.

Kundër këtij qendrimi antikombëtar të Ahmet Zogut ishte vetë kryeministri Sulejman Delvina dhe pasuesit e tij atdhetarë.

Sulejman Delvina deklaroi solemnisht në Këshillin Kombëtar, më 23 maj 1920, se «Qeveria jonë kurdoherë ka lypur dorëzimin e Vlorës dhe jep fjalën e nderit se kurrë nuk ka me u kursye me ba edhe një therori për shpëtimin e saj»¹. Për organizimin sa më të mirë të Luftës së Vlorës, nga qeveria e Tiranës u dërguan oficerë, midis të cilëve edhe Ismail Haki Kuçi, që kishte një përgatitje të mirë ushtarake dhe kulturore të gjerë.

Përsa i përkiste çlirimit të Vlorës, Sulejman Delvina dhe përkrahësit e qeverisë së tij nuk ishin për luftë frontale kundër Italisë, po për luftë të armatosur popullore, në të cilën qeveria do të paraqitej si neutrale e do të ndihmonte me rrugë të tërthortë e të fshehtë, pasi këtë taktikë e diktonin kushtet konkrete historike të vendit.

Ndërkohë, pa lënë pas dore problemet e tjera politike dhe ekonomike të vendit, qeveria e Sulejman Delvinës mori një sërë masash për të ndihmuar organizimin dhe fillimin e kryengritjes së armatosur për çlirimin e Vlorës. Ajo mbylli gazetën «Besa shqiptare», që dilte në Shkodër, pasi në artikujt e saj ngjallte përçarje në mes të shqiptarëve dhe ndaloi gazetën «Kuvendi» të

¹ Bisedimet e Këshillit Kombëtar, mbledhja e 40-të, Tiranë, f. 62, dt. 23.V.1920. AQSH i RPSSH. Fondi, Kongresi i Lushnjës, nr. 51169.

hynte në Shqipëri.¹ U akorduan shuma të mëdha të hollash dhe u ndihmuan Shkodra, Elbasani, Korça, Gjirokastra, Tirana, Mati, Dibra, Kavaja, Shijaku dhe krahina të tjera për të dërguar dhe për të transportuar armatime, ushqime, veshmbathje për luftëtarët e Vlorës.² Me sa del nga korrespondencat e zhvilluara midis prefekturave, qeveria e Tiranës kishte ngarkuar prefektin e Beratit dhe nënprefektin e Fierit që të merreshin me ndihmat e Luftës së Vlorës.

Nga kërkesat këmbëngulëse të popullit shqiptar dhe të qeverisë, që në muajin prill 1920, ushtritë italiane u tërhoqën nga krahina e Përmetit, të Këlcyrës dhe të Gjirokastrës, ku vendosi administrimin e vet qeveria e Tiranës. Më 24 maj 1920 italianët u shporrën edhe nga Kurveleshi i Sipërm. Atë ditë në Nivicë shkoi Halim Xheloja, i dërguar nga Vlora për të ngritur flamurin kombëtar shqiptar. Më 26 maj në Nivicë shkuan atdhetarë të tjerë, të cilët përgatitën terrenin për të lidhur besën, siç bënë edhe krahina të tjera. Në mbledhjen e zgjeruar të Gusmarit, të datës 27 maj 1920, u dha besa se tërë populli i Kurveleshit do të ishte i bashkuar me popullin shqiptar në luftën për çlirimin e Vlorës nga pushtuesit italianë.³

1 AQH i RPSSH, Fondi Kryeministrisë, procesverbal i Këshillit të Ministrave, dt. 29.IX.1920, gazeta «Kuvendi» dilte në Romë.

2 AQH i RPSSH, Fondi Lufta e Vlorës 1920, qarkore e qeverisë së Tiranës, dt. 22.VII.1920, qarkore e qeverisë së Tiranës, dt. 22.VII.1920 si dhe lajmërim me telefon nr.109 si dhe shkresë nga Ministria e Punëve të Brendshme.

3 AMH, VI. F. L. VI; Dosja nr. 42.

Në këto kushte forcat ushtarake italiane u detyruan të lënë tokat e pushtuara në Shqipërinë e Jugut dhe të strukeshin në Vlorë. Qeveria e Tiranës organizoi një fushatë të gjerë propagandistike kundër pushtuesve italianë në Vlorë. U organizuan mitingje protestash në Gjirokastrë, në Korçë, në Pogradec, në Elbasan, në Berat, në Shkodër dhe në qytete të tjera, ku populli kërkonte me këmbëngulje të merreshin masa për ta shpëtuar me çdo kusht Vlorën nga thonjtë e pushtuesve italianë. Kështu që për të ndihmuar Luftën e Vlorës të vitit 1920, u ngrit në këmbë i gjithë populli shqiptar. Një punë të dobishme bëri edhe «Shoqëria punëtore Gorishti», me qendër në Rexhepaj, e cila u formua në prill 1920. Ajo kishte kryetar Halim Rakipin (mulla Halimin) dhe sekretar mësuesin Rexhep Dizdari. Programi i shoqërisë ishte:

1) Propagandimi në masë për luftë kundër pushtuesve italianë, me qëllim që të shtoheshin radhët e vullnetarëve vlonjatë në Luftën e Vlorës.

2) Lufta kundër postëkomandave të karabinierisë italiane.

3) Organizimi i punës në drejtim të grumbullimit të armëve.¹ «Shoqëria punëtore Gorishti» e zhvilloi veprimtarinë e saj derisa filloi grumbullimi i vullnetarëve luftëtarë në Beun, më 2 qershor 1920.²

1 AMH VI. D. nr. 29, 40, Fshati Gorishti kishte tri lagje: Rexhepaj, Hadëraj dhe Mërtiraj. Anëtarët e «Shoqërisë punëtore Gorishti», në maj 1920, sulmuan dhe shkatërruan postëkomandën e karabinierisë italiane, me një forcë prej 6 karabinierësh dhe një xhandar. U zunë 9 pushkë, disa revolverë, bomba dore, dhe municione.

2 Në Luftën e Vlorës nga ish antarë të «Shoqërisë Punëtore Gorishti» ranë 9 dëshmorë së bashku me ko-

Në maj 1920, kur në shumë rrethe të Shqipërisë kishte shpërthyer vrulli luftarak në përkrahje të popullit vlonjat për çlirimin e Vlorës, në Korçë u krijua një komision i mbrojtjes kombëtare, i cili kishte për detyrë që me t'u larguar trupat franceze nga Korça, të mos lejonte forcat ushtarake greke që ta pushtonin këtë qytet.

Për këtë qëllim komisioni i mbrojtjes kombëtare vuri në gatishmëri popullin e Korçës dhe me urdhër të qeverisë së Tiranës u mobilizuan forca edhe nga populli i Skraparit, i Beratit si dhe nga krahina të tjera. Kur ushtria franceze u largua nga Korça, më 26 maj 1920, forcat atdhetare ngritën në qytet flamurin kombëtar dhe njoftuan zyrtarisht bashkimin e tyre me qeverinë e Tiranës¹. Kështu vepruan Pogradeci dhe Bili-shti. Kur ushtria italiane u largua nga Erseka, komandanti i tyre la dokumente kompromentuese dhe fyese, duke vërtetuar kështu se Korçën dhe Gjirokastrën ata dëshironin t'ia linin Greqisë, e cila u kishte premtuar se do t'i ndihmonte në Konferencën e Paqes, për të mbajtur të pushtuar Vlorën dhe për të ruajtur protektoratin mbi Shqipërinë.

Qëndrimi i egër e armiqësor i pushtuesve italianë ndaj vendit tonë u shfaq edhe në Tepelenë. Më 16 maj 1920, kur përfaqësuesit e qeverisë së Tiranës shkuan për të marrë në dorëzim qytetin, ushtria italiane grisi flamurin shqiptar, shpërndau egërsisht popullin dhe nxënësit e shkollave, që ishin grumbulluar për të krem-

mandantin e çetës së Gorishtit Halim Rakipin, që ishte edhe kryetar i shoqërisë.

1 Gazeta «Koha», Korçë, 10.VII.1920.

tuar kthimin e Tepelenës në gjirin e atdheut tonë, dhe vranë tradhtisht nënprefektin.¹

Me gjithë terrorin e egër që ushtronin pushtuesit italianë, fshatarët e Vlorës, të Tepele-nës, të Kurveleshit e të Mallakastrës merrnin pjesë në mbledhjet e fshehta, ku shtrohej me forcë çështja e luftës për çlirimin e vendit. Bashkë me ta përgatitej për luftën çlirimtare dhe popullsia e qytetit të Vlorës, e cila kurrë nuk që trembur përpara masave të egra dhe raprezaljeve, shkatërrimit dhe kërcënimit që bënte herë pas here komanda italiane e pushtimit. Një punë shumë të madhe në mbledhjet me popullin e fshatit dhe të qytetit, sidomos në zonën e Mesaplikut, bënte revolucionari Halim Xhelo.

Në luftën për çlirimin e Vlorës, për interesat e saj, bashkohej edhe borgjezia kombëtare shqiptare, që ishte e lidhur me tregun kombëtar, duke kërkuar ruajtjen e tërësisë tokësore të Shqipërisë. Madje ishin përfaqësuesit intelektualë të saj, që bashkë me atdhetarë dhe veprimtarë në përkrahje të luftës popullore, u vunë në krye të udhëheqjes së luftës. Vlora ishte një skelë shumë e rëndësishme dhe më e madhja në Shqipërinë e Jugut, që lidhte me detin gati një të tretën e atdheut. Shkëputja e Vlorës nga pjesa e Shqipërisë dëmtonte ekonomikisht jo vetëm borgjezinë e qytetit, por edhe atë të krejt vendit. Këtë fakt historik borgjezia jonë kombëtare e kishte deklaruar në memorandumet drejtuar Fuqive të Mëdha, si një nga arsyet kryesore të kërkesave të saj për bashkimin e Vlorës me atdheun.² Por ajo që ishte më shumë e interesuar për

1 Gazeta «Drita», Gjirokastër, 22.V.1920.

2 AQH i RPSSH, F.L. VI., nr. 51389.

fatet e Vlorës e të Shqipërisë ishte vegjësia, marrësat popullore fshatare e qytetare.

Fshatarësia dhe vegjësia e qytetit, ndryshe nga klasa e bejlerëve dhe e çifligarëve, nuk e shikonin dot Vlorën të pushtuar, nuk duronin dot atdheun nën zgjedhë, në skllavëri dhe qenë gati të hidheshin në luftë të armatosur, pa marrë parasysh asnjë sakrificë dhe as numrin e madh të pushtuesve, sadoqë të armatosur me armët më moderne të kohës, të përqendruar në krahinën e Vlorës.

Bejlerët dhe çifligarët përkrahnin politikën italiane, duke nxjerrë tezën e pranimit në Shqipëri të një force të huaj të armatosur, si i vetmi mjet që do ta «shpëtonte» shtetin shqiptar pas Luftës së Parë Botërore. Këtë e kishte pranuar edhe një pjesë e përfaqësuesve të borgjezisë. Me qëndrimin e çifligarëve u bashkuan edhe klerikët e lartë, që përfaqësonin pjesën tjetër më reacionare të vendit.

Qëllimi i bejlerëve, i çifligarëve dhe i klerikëve të lartë, që i shërbenin politikës italiane në Shqipëri, ishte që të siguronin pushtetin politik në Shqipërinë e pasluftës, si armë për të mbrojtur bazën e tyre të kalbur ekonomike — pronën çifligare mbi tokën dhe marrëdhëniet gjysmëfeudale në prodhim. Përfaqësuesit e çifligarëve ishin të vetëdijshëm se këtë pushtet nuk mund ta ruanin dhe ta forconin pa ndihmën e huaj. Baza e tyre shoqërore ishte e kalbur. Ata e kishin frikë popullin. Mosbesim në masën popullore kishin edhe shumë përfaqësues të borgjezisë, sidomos ata që ishin lidhur me tokën.

Vendosjen e shtetit shqiptar nën «mbrojtjen» e Italisë nuk e përkrahën rrethet më të gjera të borgjezisë, nga fakti se vërshimi i kapitalit të huaj italian do të ishte në dëm të interesave të tyre.

Pjesa më e përpëruar e borgjezisë kombëtare kërkonte vënien në jetë të vendimeve të Kongresit të Lushnjës: çlirimin e Vlorës me kryengritje të armatosur. Në këto rrethana politike përfaqësuesit e lëvizjes sonë kombëtare përcaktuan drejt së armiku kryesor ishte imperializmi italian.

Kështu që në fazën përgatitore u bë e qartë se forca kryesore lëvizëse e Luftës së Vlorës ishin masat popullore. Pjesëmarrja e të gjitha shtresave të popullsisë në lëvizjen çlirimtare bëri që kryengritja për çlirimin e Vlorës të përgatitej dhe të organizohej më mirë.

Me qëllim që t'i prisnin hovin lëvizjes çlirimtare shqiptare, pushtuesit italianë filluan të merrnin një sërë masash kundër interesave kombëtare të Shqipërisë, duke krijuar qëllimisht situata të vështira. Ata kryenin provokacione, organizonin banda terroriste, krijonin panik në vend, qëllonin me pushkë kundër fshatarëve, shkatërronin ndërtesat publike dhe ato të banimit, si në Kërrabë, Tiranë, në Shijak, në Vlorë, në Gjirokastrë etj.¹

Më 18 maj 1920 pushtuesit shpallën shtetrrëthimin, ndaluan mbledhjet jashtë qytetit, hapjen e dyqaneve pas orës 22, mbajtjen e armëve, ceremonitë fetare të bëra jashtë vendit të caktuar, zbrazjen e pushkëve e të tjera. U dha urdhri për arrestimin e personave të «dyshimtë», për lidhjen e tyre me Komitetin e Mbrojtjes Kombëtare. Jo vetëm kaq, por pushtuesit ndërprejnë trafikun e krahinës së Vlorës me pjesët e tjera të vendit,

¹ AQSH i RPSSH, FM P Br, Dok. nr. 327, datë 6.3.1920, si dhe AMH VI, D. 57, gazeta «Drita», Gjirokastrë, 22.5.1920.

u shpërndanë fshehurazi armë e municione nje-
rëzve, që ishin në shërbim të tyre etj.

Në këto kushte gjendja e vendit bëhej çdo
ditë e më kritike. Kontradiktat themelore midis
popullit e pushtesit kishin arritur kulmin. Du-
hej vetëm një shkëndijë që të shpërthente zja-
rri i kryengritjes së armatosur.

KUVËNDI I BARCILLASË DHE Mbledhja E HENIT

Me propozim të Kryetarit, mjaft kritike e plot-
veshticat politike, ekonomike, shpërndarje dhe ush-
tarake të brendshme e të jashtme — kur Vitor
mbahet e pushtuar nga imperia italiane dhe
pavarësisht e tërësia tokësore ishin në rrezik kry-
esor. Në këto kushte të pushtimit italian, mbledhja
e tërësive të bashkuara ku do të dilte një udhëheqje
për tërësinë drejt të Luftës së Vlorës dhe për
shpërndarjen e vlerave të Kongresit të Lushnjës
në një domosdoshmëri historike.

Me këto kushte, më 29 maj 1920, në Barcilla
(Dukat) u mbledhën ligjërisht kuvëndi i Vlorës.
Kuvëndi përbëhet nga Komiteti i «Mbrojtjes Ko-
ngresore» prej 13 vetësh me kryetar Osman Ha-
xim.

Në Barcilla u zgjedhën një komision ushtarak,
i cili do të hartonte planin e luftimeve dhe një-
kohërisht do të hartonte me organizimin e çetave
ushtarake në tërësi kundër pushtesve italianë.
U zgjedhën një komision gjyqësor ushtarak për të

KUVENDI I BARÇALLASË DHE MBLEDHJA E BEUNIT

Në rrethanat e krijuara, mjaft kritike e plot vështirësi politike, ekonomike, shoqërore dhe ushtarake të brëndshme e të jashtme — kur Vlora mbahej e pushtuar nga imperializmi italian dhe pavarësia e teresia tokësore ishin në rrezik kryesisht për shkak të pushtimit italian, mbledhja e një kuvëndi nga ku do të dilte një udhëheqje për drejtimin direkt të Luftës së Vlorës dhe për zbatimin e vendimeve të Kongresit të Lushnjës u bë një domosdoshmëri historike.

Në këto kushte, më 29 maj 1920, në Barçalla (Dukat) u mbledh ilegalisht kuvëndi i Vlorës.

Kuvëndi zgjodhi Komitetin e «Mbrotjtjes Kombëtare» prej 12 vetësh me kryetar Osman Haxhiun.

Në Barçalla u caktua një komision ushtarak, i cili do të hartonte planin e luftimeve dhe njëkohësisht do të merrej me organizimin e çetave vullnetare në luftën kundër pushtuesve italianë. U zgjodh një komision gjyqësor ushtarak për të



Avni Rustemi



Halim Xhelo



Joni Minga



Osman Haxhiu

marrë masa kundër atyre që do të tradhëtonin atdheun dhe do të bashkëpunonin me armikun. U caktuan edhe disa antarë komiteti, që do të organizonin dhe drejtonin punën administrative gjatë zhvillimit të luftës.

Në kuvënderin e Barçallasë u morën këto vendime të rëndësishme:

1. I gjithë populli të bashkohej në një front të vetëm, duke lënë mënjanë çdo grindje të mëparshme dhe të pajtoheshin gjaqet.

2. U vendos njëzëri fillimi i luftës së armatosur kundër pushtuesve italianë dhe njëkohësisht të zhvillohej një punë propagandistike me popullin duke bërë të qartë qëllimin pushtues të Italisë në Vlorë.

3. U vendos të shkonin delegatë në krahinat e tjera të Shqipërisë, me qëllim që të merreshin masa urgjente në ndihmë të Luftës së Vlorës, si në Gjirokastrë, në Kurvelesh, në Tepelenë, në Korçë, në Berat, në Elbasan, në Durrës e tjera.

4. U vendos gjithashtu që grumbullimi i forcave vullnetare luftarake shqiptare të bëhej në 2 qershor 1920 në Beun, prandaj gjithë pjesëmarrësit me të shkuar në krahinat e tyre, me një herë dhe në mënyrë të rrufeshme, të mblidhnin vullnetarë dhe të formonin çetat. Brenda disa ditëve u formua një ushtri kryengritësisht prej rreth 4000 vullnetarëve, ndër të cilët kishte edhe gra, si heroina e popullit Sado Koshena etj.

Vendimet e Kuvënderit të Barçallasë ishin shprehje e vullnetit të gjithë popullit shqiptar. Mbledhja e këtij kuvendi ishte rezultat i vrullit luftarak që kishte shpërthyer në mbarë vëndin tonë, rezultat i vendosmërisë së popullit shqiptar në luftën e tij të drejtë për çlirimin e Vlorës, duke u mbështetur tërësisht në forcat e veta. Këto përgatitje e ky organizim hedhin poshtë trilli-

met e imperialistëve italianë e të historigrafisë së tyre se Lufta e Vlorës ishte një kryengritje rebelash. Në këtë Luftë u angazhuan forcat më të mira të kombit dhe kuadro me përgatitje politike e ushtarake.

Për të vënë në jetë këto vendime u mobilizuan gjithë Komitetet e «Mbrojtjes Kombëtare».

Më 2 qershor 1920 në Beun u grumbulluan qindra vullnetarë. Rreth 75 fshatarë nga Nivica, nga Rexhina dhe nga Gusmari arritën në Beun, më 3 qershor¹. Këtu erdhën edhe përfaqësues nga Vunoï dhe nga Himara². Drejt Beunit marshoi edhe batalioni i milicisë shqiptare, i përbërë prej 300 vetash, që dezertuan nga ushtria italiane, në përgjigje të thirrjes që bëri udhëheqja e kryengritjes.

Në praninë e qindra luftëtarëve vullnetarë, midis brohoritjeve të zjarra, Komiteti i Mbrojtjes Kombëtare deklaroi shpalljen e luftës kundër imperialistëve italianë. Para luftëtarëve të mbledhur këtu u ngrit flamuri kuq e zi.³ Fjalën e rastit e mbajti kryetari i Komitetit të Mbrojtjes Kombëtare Osman Haxhiu⁴.

Komisioni ushtarak hartoi përfundimisht planin e luftës. U patën parasysh formacionet luftarake, traditat e popullit tonë, njëkohësisht edhe forcat e armikut, pajisjet e tyre etj. U caktuan goditjet që do t'u bëheshin garnizoneve italiane,

1 AMH VL, Dok. 42. Në kujtimet e një pjesëmarrësi midis të tjerash thuhej: «Letrën nga Komiteti i Mbrojtjes Kombëtare, Vlorë, e mora, më 30 maj, ku lajmërohen për datën 2 qershor për në Beun».

2 Po aty, Dok. nr. 49.

3 Po aty, Dosja nr. 38.

4 Po aty, Dosja nr. 37.

rrugët që do të ndiqnin çetat, lidhjet që do të mbanin gjatë luftës me qendrën etj.¹

Komisioni ushtarak bëri një mbledhje me komandantët e çetave vullnetare, ku u fol rreth detyrave që ata do të kishin gjatë luftimeve dhe u caktuan edhe vendet ku do të luftonin çetat. Forcat vullnetare u përqendruan në Kotë, në Gjormë, në Drashovicë, në Matohasanaj dhe në Llogara.² Plani i kryengritjes, i hartuar nga komisioni ushtarak, parashikonte si detyrë të afërme shpërthimin e menjëhershëm të sulmit mbi garnizonet e veçuara të ushtrisë italiane, shkatërrimin e tyre si dhe rrethimin e Vlorës. Furnizimi i frontit do të bëhej nga populli. Për organizimin dhe për drejtimin e kësaj detyre u caktua një komision prej 5 vetash.³

Komiteti i Mbrojtjes Kombëtare, së bashku me luftëtarët vullnetarë të mbledhur aty, bënë betimin solemn se do të luftonin deri në vdekje për t'i hedhur në det italianët dhe për të çliruar Vlorën.⁴

Disa nga anëtarët e Komitetit të Mbrojtjes Kombëtare dhe të komisionit ushtarak u caktuan dhe për udhëheqjen e çetave. Në këto rrethana, Komiteti i Mbrojtjes Kombëtare, më 3 qershor 1920, para se të fillonte lufta, i dërgoi komandës së trupave të pushtimit italian në Vlorë një ultimatum, ku kërkohet që ata trupa të largoheshin nga Shqipëria, duke thënë midis të tjerash: «Populli shqiptar nuk mund të pranojë ndarjen e Shqipërisë sipas Traktatit të fshehtë të vitit 1915. Sot populli shqiptar, i bashkuar më shumë se

1 AMH, VI, Dosjet nr. 36-14.

2 Po aty, Dosjet 37, 42, 44 e tjera.

3 AMH VI, Dosja 37.

4 AMH, VI, FL VI, Dosja 37.

çdo herë, duke mos mundur të durojë të shitet si bagëti nëpër pazaret e Evropës, si shpërblim italo-greko-serbëve, vendosi të marrë armët dhe të kërkojë nga Italia administratën e Vlorës, të Tepelenës e të Himarës, të cilat t'i dorëzohen me të shpejtë Qeverisë Kombëtare të Tiranës».¹

Në emër të popullit, Komiteti i Mbrojtjes Kombëtare i kërkonte përgjigje komandës italiane deri në orën 19 të datës 4 qershor, ndryshe për çdo gjë që do të ngjiste e quante veten të shkarkuar nga çdo përgjegjësi.

Menjëherë pas dërgimit të ultimatumit, sipas planit të kryengritjes, çetat u nisën dhe zunë vendet, duke qenë të gatshme për sulme kundër pozicioneve italiane.

Komanda e ushtrisë italiane e hodhi poshtë me përbuzje ultimatumin. Në këto rrethana Komiteti i Mbrojtjes Kombëtare, më 5 qershor 1920, dha urdhrin për të nisur sulmin kundër pushuesve.

¹ «Historia e Shqipërisë», vëll. 3, Tiranë, 1984, f. 224-225.

SHKATËRRIMI I POSTËKOMANDAVE ITALIANE

Në pragun e Luftës së Vlorës ushtria italiane kishte nën pushtimin e vet gjithë krahinën e Vlorës, të Tepelenës dhe të Sarandës. Fuqitë e pushtuesve ishin të shumta në numër dhe kishin armatime nga më modernet e kohës: dy divizione këmbësorie, divizionin e 13-të, divizionin e 36-të, një brigadë speciale, reparte të posaçme artilerie, reparte të xhenjos, të karabinierisë, një skuadër aeroplanësh, reparte autobлиндash e tankesh dhe një skuadër të flotës luftarake. Në tërësi, ushtria italiane kishte rreth 20000 forca në Shqipëri, pjesa kryesore e të cilave ishte përqendruar në Vlorë. Jashtë qytetit të Vlorës ushtarët italianë kishin zënë pozicione me rëndësi strategjike, gjatë rrugës Vlorë-Tepelenë dhe asaj Vlorë-Himarë.

Përballë një armiku të tillë do të luftonin vullnetarët shqiptarë që arritën në rreth 4000 veta. Ata ishin me armë e pa armë, me fishekë dhe pa fishekë, të veshur dhe të zbathur, pa artileri,

pa kuadro të stërvitur për luftë frontale. Për drejtimin dhe për udhëheqjen e çetave, vullnetarët kishin zgjedhur trima të vendosur, që kishin dhënë prova dhe më parë për mbrojtjen e Atdheut. Kështu, p.sh., çeta e Salarisë ishte nën komandën e Selam Musait, atë të Vranishtit e udhëhiqte Sali Vranishti (Sali Murati), të Smokthinës Zigur Leloja, të Tërbaçit Selman Hyseni, të Kabinës Beqir Veloja, të Gorishtit Halim Rakipi e tjerë.

Në komisionin ushtarak kishte oficerë të përgatitur e të aftë për ta organizuar luftën. Edhe në udhëheqjen kryesore politike kishte veprimtarë me përvojë. Këta bënë përgatitje të mëdha jo vetëm me masat popullore, por edhe me ushtarakët shqiptarë.

Përveç garnizoneve të rregullta, pushtuesit kishin vendosur njësi të vogla karabinierie në disa pika të rëndësishme jashtë qytetit të Vlorës, me qëllim që të mbanin «qetësinë», d.m.th. të ndalonin mbledhjet e popullit, të ndalonin krijimin e shoqërive ose të klubeve atdhetare etj.

Komiteti i Mbrojtjes Kombëtare dha urdhër që postëkomandat e karabinierisë italiane të shkatërroheshin me sulme të rrufeshme nga luftëtarët vullnetarë të fshatit përkatës ku ato ishin vendosur, para datës 5 qershor. Disa prej tyre qenë shkatërruar shumë ditë përpara. Kjo luftë nisi me prerjen e linjave telefonike e telegrafike, që lidhnin periferinë me Vlorën. Kjo gjë u bë me qëllim që të pritej rruga (lidhja) midis postëkomandave e qendrës, duke mos mundur kështu që ata të kërkonin ndihmë të shpejtë ushtarake nga Vlora.

Postëkomanda e karabinierisë italiane në Sevaster u shkatërrua menjëherë nga sulmi i rrufeshëm i një pjese të çetës së Sevasterit. U zunë

armë, municione, ushqime e tjera, kurse robërit u shpunë në katundin Vajzë. Të njëjtin fat pësoi edhe postëkomanda e karabinierisë e Mazharit nga luftëtarët vendas. Në fshatin Vajzë u ngrit kampi i përqendrimit të robërve italianë të luftës¹. Në shkatërrimin e postëkomandës italiane të Vajzës u zunë 2 mitraloza, 30 robër dhe u vranë 7 karabinierë italianë. Nga luftëtarët vullnetarë nuk pati asnjë humbje².

Mandej u shkatërruan me radhë postëkomandat në Peshkëpi, ku u zunë robër 12 veta dhe një mareshal, në Rexhepaj, në Panaja, në Besrovë, në Tragjas, në Dukat, në Selenicë, në Ramicë. Postëkomandat italiane, që ishin vendosur në këto vende, u shkatërruan brenda 2-3 orëve para datës 5 qershor. Vullnetarët smokthiniotë zunë në zonën e Smokthinës 70 karabinierë kalorës dhe i shpunë në Vajzë³. Në Progonat, në Kuç, në Bolenë, postëkomandat e karabinierisë italiane u larguan nga presioni i popullit.

Pas shkatërrimit të postëkomandave të karabinierisë italiane, vullnetarët vlonjatë, tepeleñas e kurveleshas u vendosën në pozicionet e caktuara dhe me padurim prisnin sinjalin e sulmit mbi garnizonet italiane.

1 AMH VI, F.L. VI. D. nr. 38.

2 Po aty, Dosjet nr. 39, 44; AQH i RPSSH, FL, VI, Dok. 38, original.

3 Gazeta «Drita», 9.VI.1920.

FAZA E PARË E LUFTIMEVE

(5-10 QERSHOR 1920)

ÇLIRIMI I KOTËS

Nga ana juglindore, lindore dhe verilindore Kota rrethohet nga një vargëzim kodrash. Nga ana perëndimore kalon lumi Shushicë. Në një fushë të vogël, pushtuesit italianë kishin ndërtuar kazermat ushtarake dhe një spital. Kota është një vend strategjik dhe mbrohet nga një sërë kodrash në formë kështjellash.

Garnizoni i Kotës komandohej nga gjeneral Goti. Ishte i pajisur me armatime, me automjete, me municione dhe me rezerva ushqimore të shumta. Ai përforcohej nga një bateri malore, topa e mitraloza të rëndë. Kuotat nr. 115 dhe 124 ishin përforcuar me dy topa malorë dhe me 20 mitraloza etj. Vendi ishte rrethuar me katër rradhë gardhesh me tela gjembash, ishin ndërtuar fortifikata e llogore betonarmeje etj.

Garnizoni ushtarak i Kotës u rrethua nga këto çeta vullnetare: e Smokthinës, e Sevasterit,

e Mavrovës, e Salarisë, e Bolenës, e Vërmikut, e Gorishtit dhe nga ajo e Kurveleshit të Sipërm.

«Dy orë para se të fillonte sulmi mbi Kotë, shkruan në kujtimet e tij Rexhep Sulejmani, së bashku me Halim Xhelon i shpëmë gjeneral Gotit një letër, në të cilën, midis të tjerash, shkruhej «se për popullin e Vlorës tashmë ishte bërë e padurueshme të priste largimin e italianëve vullnetarisht dhe se ai kishte vendosur të çlironte Vlorën vetë. I propozohej të dorëzoheshin pa e filluar luftën. Por përgjigje nuk u dha».¹

Luftëtarët shqiptarë, kur panë se kaloi afati i dhënies së ultimatimit, me të marrë urdhrin e sulmit, të gjithë me një zë thirrën: «Rroftë liria! Rroftë vatani ynë!». Çetat vullnetare në luftën e Kotës ishin nën komandën e Ahmet Lepenicës². Sulmi filloi duke u gdhirë data 5 qershor 1920, nga ana verilindore e Kotës, drejt kuotës 115 kundër 150 ushtarëve armiq.³ U zhvilluan sulme të rrufeshme dhe u arrit që brenda një ore të pushtoheshin kuotat 115 e 124. Nga armiqtë u vranë 105 veta dhe u plagosën 60 veta, midis syresh edhe një kolonel i artilerisë.

Në bazë të planit të luftimeve, për marrjen e Kotës, çetat sulmuan dhe zhvilluan luftime në këto drejtime: Çeta e Smokthinës, me komandant Zigur Lelon, luftoi nga ana jugore, zuri pozicion në Qafën e Dushkut dhe me sulm të rrufeshëm kaloi urën, duke iu afruar pozicioneve armike rreth 12-15 metra në të djathtë të urës. Në sulm e sipër u vra trimi i shquar smokthiniot, komandanti i çetës, Zigur Lelo⁴

Nën shembullin e komandantit të çetës, lu-

1 AMH, VI, FL, VI. Dosja e kujtimeve.

2 AMH, VI, D. nr. 48.

3 Gazeta «Koha», Korçë, 10 korrik 1920.

4 AMH, VI. Po aty.

ftëtarët trima smokthiniotë, me gjithë mbrojtjen e fuqishme të armikut, i thyen ata pasi i shkatërruan telat me gjemba dhe duke u përleshur fyt më fyt, hynë në Kotë nga ana jugore.

Çeta e Mavrovës, me komandant Isuf Rustemin, luftoi në verilindje të Kotës, në Majën e Shkallës. Luftëtarët u hodhën me tërbim në pozicionet e armiqve dhe këta të fundit u tërhoqën në panik në thellësi, ndërsa çeta e Salarisë me komandant Selam Musanë luftonte në anën veriore, kurse në anën veriperëndimore luftonin vullnetarët e çetës së Kurveleshit të Sipërm. Çetat kishin për detyrë jo vetëm të sulmonin dhe të thyenin mbrojtjen e armikut, por të mos lejonin ndihmat ushtarake që mund të vinin nga Vlora.

Selam Musai sulmonte në ballë të shokëve. Lufta u ndez e rreptë. Tymi dhe flaka i mbështollën luftëtarët shqiptarë, kurse plumbat derdheshin me breshëri. Megjithatë ata vazhdonin të sulmonin. «Përpara djema!» — thërriste Selami «Të gjallë i kapni breshkamanët!» dhe bashkë me shokët u hodh mbi telat me gjemba, drejt pozicioneve të fortifikuara të armikut.

Zjarri i armikut u bë edhe më i dendur. Gjylet e topave binin mbi luftëtarët, duke qëlluar nga njëqid-dyqind metra larg. Qëllonin pa pushim pushkët e mitralozat.

Selami u drejtua nga një top që ishte vendosur në një pozicion pas llogores së ushtarëve armiq dhe që pengonte luftëtarët të përparonin. Heroi i Salarisë sulmoi me guxim të papërmbajtur drejt topit dhe, duke përdorur herë pushkën e herë koburen, asgjësoi disa prej artiljerëve armiq, kurse të tjerët ikën nga sytë këmbët për të shpëtuar lëkurën. Mbi topin e kapur Selami vendosi një flamur.

18 Përleshja e ashpër e trup me trup vazhdoi gjithë natën. Luftëtarët e çetave hidheshin me guxim përpara për të thyer qëndresën e repar-teve pushkatore dhe të baterive të artilerisë.

19 Gjeneral Goti dhe shtabi i tij ndiqnin hap pas hapi situatën, që vështirësohej vazhdimisht, dhe bënë çmos që luftëtarët shqiptarë të mos futeshin brenda sistemit të mbrojtjes. Kur ai mori vesh se pozicionet e artilerisë po rrezikohe-shin të binin në duart e luftëtarëve kryengritës, menjëherë u nis për atje, me gjithë oficerët e shtabit, me qëllim që të ngrinte lart moralin e ushtarëve të tij, të cilët, nën goditjen e luftëtarëve shqiptarë, po i linin pozicionet një nga një. Gjenerali italian, i dëshpëruar në kulm nga kjo dis-fatë e shpejtë që pësoi ushtria e tij, bashkë me 13 oficerë të shtabit të forcave të Kotës, u mbyll në një ndërtesë dhe që aty vazhdonte të jepte urdhra për vazhdimin e qëndresës. Kryengritësit e rrethuan shtabin armik plotësisht. Rreth 100 metra larg ndërtesës së shtabit qëndronte Se-lam Musai. Që këtej ai i dha gojarisht ultimatum-in e fundit shtabit armik që të dorëzohej pa kushte, ndryshe do të asgjësoheshin tërësisht.

Por armiqtë e rrethuar nuk dhanë përgjigje.

20 Një ushtarak italian i zënë rob u dërgua në shtabin e armikut për të dhënë urdhrin e dorëzimit pa kushte e për të marrë përgjigje. Ndërkohë kryengritësit i ishin afruar më tepër ndërtesës dhe e ngushtuan rrethimin. Te porta e jashtme, rreth 20 metra larg nga dera e dhomës së gjeneralit, u vendosën tre luftëtarë të çetës së Gernecit si dhe një tjetër nga Nivica.

21 Gjeneral Goti, pasi e pa gjendjen kritike dhe të pashpresë, u detyrua të përgjigjej se ishte dakord të dorëzohej. Pas pak në dritaren e dhomës së tij u duk një flamur i bardhë, shenjë

e dorëzimit. Nuk kaluan as pesë minuta dhe ai vetë doli te shkallët. Pas tij dolën edhe oficerët e tjerë.¹

Kryengritësit u çuan në këmbë dhe e kaluan portën e jashtme të oborrit për të shkuar drejt tij. Por në këto çaste, në mënyrë të befashisme, disa nga ushtarët armiq hapën zjarr të dendur e hodhën bomba kundër luftëtarëve tanë.

Nga ky provokacion u vra Dushan Kaçoja, i cili, para se të vdiste, thirri: «Na vranë me të pabesë. Na e merrni hakun vëllezër!» Dhe populli i këndoi:

*«Të dielën në saba
U vra Dushan Kaçua
Briti: «O Selam Musa,
Merrëm hakën, o vëlla!...»*

Një luftëtar i çetës së Nivicës, i cili qe afër Dushanit, kur pa që breshkamanët hapën zjarr, qëllloi me pushkë gjeneralin armik, duke e lënë të vrarë në vend.

Dylbitë e gjeneral Gotit ndodhen edhe sot të ekspozuara në Muzeun Historik të Tepelenës.

Krahas çetës së Salarisë luftonte ajo e Bolenës, me komandant Toto Hosin, që sulmonte nga ana e veriperëndimit. Në fushën e betejës, në përleshje me armikun ra trimërisht komandanti trim Toto Hosi.² Bri çetës së Bolenës luftonte edhe ajo e Vermikut me komandant Naim Brakën. Ndërsa çeta e Sevasterit, me komandant Rrapo Çelon dhe me zëvendëskomandant trimin

1 Xh. Matuka, *Selam Musa Salaria*, Tiranë, 1975, f. 101.

2 AMH, VI, Dosje 42, Toto Hosin e zëvendësoi menjëherë trimi bolenas Mato Robi.




Selam Musai



Zigur Lelo



Sado Koshena



Kanan Maze, kishte zënë vend në juglindje të Kotës, në Garxhian.

Në sulmin mbi Kotë, luftëtarët e çetës së Sevasterit, duke vazhduar sulmin në thellësi të mbrojtjes së armikut, treguan shembuj të rrallë heroizmi, duke u përleshur trup me trup me armikun. Kanan Mazia, në krye të luftëtarëve, duke ndjekur traditat e komandantëve paraardhës, u hodh në sulm, u përlesh grykë për grykë me armiqtë dhe në luftim e sipër u godit nga një plumb që ia dërrmoi nofullën. Megjithëse i plagosur rëndë nuk e ndërpreu sulmin. I ndjekur nga luftëtarët e çetës së Sevasterit, luftoi deri në marrjen e plotë të Kotës. Heroizmit të tij populli i këndoi:

«... Kanan t'u prish bukuria

Le të rrojë Shqipëria!

Shqipëria le të rrojë.


Ç'ka se mbeta unë pa gojë!»

Në fushën e luftës dëgjohej sokëllima e luftëtarëve të çetës së Kananit: «—Përpara djema, për gryke t'i zëmë.» Ndërkohë tri bomba plasën m'u aty ku nxirrnin flakë mitrolozat. Ishte Kanani, Hodo Mahili dhe Qerim Dervishi që iu sulën bunkerëve dhe i asgjësuan. Që të tre u plagosën, por çetës i hapën rrugën drejt fitores. Një sulm tjetër, dhe kryengritësit u gjendën para kazermave. Italianëve u hyri tmerri në palcë dhe filluan të ngrënë duart përpjetë. Çeta e Gorishtit, me komandant Halim Rakipin, zhvilloi luftime në verilindje të Kotës. Gorishtiotët u futën në thellësi të mbrojtjes së armikut. Terreni ishte i vështirë, por ata i ndihmoi errësira e natës dhe shpejtësia e sulmit. Mëngjesi e zuri armikun të çorientuar dhe të paaftë

për të vepruar. Gjatë luftimeve u vra një nga luftëtarët e Gorishtit, Salo Islami, dhe u plagosën shumë të tjerë.

Kryengritësit, pa marrë parasysh vdekjen, luftonin dhëmb për dhëmb, me heroizëm, duke sulmuar nga të gjitha drejtimet. Ata kalonin telat me gjemba, mbasi hidhnin mbi ta gunat e tyre, që u bënë edhe këto armë sulmi dhe kështu shkollonin përpara. Pas 5-6 orë luftimi, Kota u çlirua. Në këto luftime u vranë 80 armiq, midis tyre edhe komandanti i trupave italianë në Kotë, gjenerali Goti dhe u plagosën 60 të tjerë. U zunë robër 365 veta dhe 4 topa, 36 mitraloza, disa automobila, 200 pushkë, armë, municione të shumta, veshmbathje, ushqime e pajisje të tjera. Në spitalin e Kotës u zunë shumë barna dhe vegla mjekësore që u përdorën për mjekimin e të plagosurve.

Ne tashmë e lumë degjohet sokëllima e
luftimeve të qytetit të Kanarit. — Përpara dhe
me për gjyke të kënd. Ndërkohë tri bomba
pleshën mbi qytetin në rrethim të mitralozat.
Janë Kanarit, Hodo Manili dhe Gerta Lervi.
Atë ditë të sulmimit dukëshe dhe i ngjësuar. Që
të të u plagosën por qyteti i hapur hapën drejt
fitorës. Më sulm tjetër dhe kryengritësit u gjë-
në përpara Kanarit. Luftimeve u për të
atë gjatë dhe filluan të ngrenë duart përjetë.
Cela e Gorishtit me komandant Haim Rak pin,
shkëlqoi luftime në verditje të Kotes. Gor-
shitetit u turr në mënyrë të rëndësishme se ar-
mikut. Luftimeve të vështur por ata i shpëton
qytetit e mës dhe shpëton e sulmit. Mënyrë-
si e xort armikut të qytetit dhe të qytetit




Pamje e Kotës, ku u zhvilluan luftimet



Pamje nga Gjormi

Pamje nga Sherishta



ÇLIRIMI I DRASHOVICËS, I GJORMIT, I LLOGARASË

Në luftën e Drashovicës morën pjesë çeta e Kaninës, e Vranishtit, me të cilën u bashkua dhe një grup luftëtarësh nga Borshi, dhe ajo e Gumenicës, me të cilën u bashkuan vullnetarë edhe nga Lapardhaja, nga Mazhari e nga Vodica.

Çeta e Kaninës zuri pozicion në qendër nga ana perëndimore e kazermave, e Vranishtit nga ana jugore dhe juglindore, duke pasur përballë urën, ndërsa çeta e Gumenicës nga ana lindore. Garnizoni italian në Drashovicë u rrethua nga të katër anët. Luftëtarët e njohnin shumë mirë terrenin dhe kjo e lehtësoi sulmin e tyre mbi armikun. Çeta e Vranishtit u nda në dy grupe. Grupi që komandohej nga Sali Murati, zuri anën e rrugës Vodicë—Lapardha si dhe anën e rrugës që vinte nga Kota për t'u prerë rrugën italianëve, që mund të vinin andej, ndërsa tjetri, që e komandonte Daut Seferi,

zuri rrugën që vinte nga Vlora, Një grup i çetës së Gumenicës u ngarkua të prishte urën e Qishbadhës dhe atë të Kallafetit me qëllim që t'u pritej rruga forcave që mund të vinin në ndihmë të garnizonit të Drashovicës.

Përpyekja e Drashovicës filloi në orën 2,30, të datës 5 qershor 1920. Luftëtarët sulmuan dhe u futën menjëherë në pozicionet e italianëve, të cilët i braktisën. Në orën 4⁰⁰ të datës 5 qershor 1920, garnizoni i Drashovicës kapitulloi.

Për marrjen e Drashovicës në dorëzim Komiteti i Mbrojtjes Kombëtare dërgoi dy anëtarë të tij. Në këtë përpjekje u vrahë 30 italianë dhe u zunë 40 robër, një top, tre mitraloza, shumë arka me municion, pushkë, ushqime, veshmbathje, ilaçe etj.¹

Nga kjo datë Drashovica u bë vendqëndrimi i Komitetit të Mbrojtjes Kombëtare dhe vend grumbullimi i vullnetarëve, i ushqimeve, i armatimeve etj. Që këtej Komiteti i Mbrojtjes Kombëtare drejtonte luftimet. Duke e ditur këtë, pushtuesit italianë e bombarduan disa herë me aeroplanë dhe artileri.

Ja si i përjetëson populli në këngët e tij këto bombardime:

*«Tek ura në Drashovicë,
Qëllon topi i Italisë,
Ka niet që ta vidhisë,
Komision e Shqipërisë...»*

Në kohën kur filloi lufta në Drashovicë, nisi dhe sulmi mbi garnizonin e Gjormit. Këtu ishte vendosur një repart këmbësorië, një kom-

1 AQH i RPSSH, Dosje 1, Dok. nr. 38; origjinal, dt. 17.VI.1920.

pani mitraljerësh, një kompani e divizionit të artilerisë dhe disa karabinierë italianë.

Përballë këtyre forcave të armikut, ishin përqendruar nga ana jugore çeta e Gjormit, nga ana lindore dhe veriore ajo Dukat — Tragjas — Radhimës, dhe nga ana jugperëndimore ajo e Progonatit. Më vonë kjo e fundit u inkuadrua në çetën e Kurveleshit të Sipërm. Një grup luftëtarësh të çetës së Vranishtit luftuan nga veriperëndimi, ndërsa një grup i çetës së Tërbaçit nga ana perëndimore.

Sulmi i çetave ishte i shpejtë dhe i organizuar.

Në Gjormë u zhvilluan luftime të rrepta dhe përlëshje trup me trup. Megjithëse forcat e garnizonit armik këtu bënë një rezistencë të fortë, sulmi i shpejtë i luftëtarëve i detyroi të thyhen keqas. Brenda 2-3 orëve forcat armike, të pajisura me artileri dhe me armë të tjera speciale, kapitulluan. Nga forcat e luftëtarëve vullnetarë vlonjatë u zunë 2 topa, 7 mitraloza, u vranë 40 ushtarë armiq, u zunë 80 robër, si dhe një sasi e madhe municionesh, ushqimesh, pushkë e të tjera. Robërit u dorëzuan në Vajzë.¹ Në fushën e betejës ra komandanti i çetës Dukat — Tragjas e Radhimë Hodo Zeqiri nga Dukati. Ranë gjithashtu Hysen Beqiri nga Dukati, Zenel Ramohito nga Tragjasi dhe Zykë Metani nga Dukati. U plagosën edhe shumë të tjerë.

Populli u këndon dëshmorëve, që dhanë jetën për çlirimin e Gjormit:

«Që në Gjormë e Llogara,
Një mjegull e zezë ra,

¹ AQH i RPSSH, FL, VI, Dok. 38, original AMHV1, D. 35-37, 44, 47.

Në Dukat u bë hata,

Thonë u vra Hodua,

Hysen Beqir Jazua,

Zenel Ramohitua,

Zykë Metan Luleja.

Pas shkatërrimit të garnizonit të Gjormit, çeta e Dukat—Tragjas—Radhimës kaloi në luftën e Llogarasë, që ishte ndër pikat e rëndësishme strategjike për pushtuesit si dhe ajo e Kotës. Kota lidhte Vlorën me Tepelenën, kurse Llogaraja Vlorën me Himarën. Qëkurse u vendosën në Llogara pushtuesit bënë përforcime të shumta. Këtu ishte përqendruar një batalion karabinierësh dhe batalioni i katërt alpin, të pajisur këta me artileri dhe me armë të tjera speciale.

Përballë këtyre forcave të armikut u vendosën çetat e Dukatit, të Tragjasit, të Radhimës, të Gjormit, të Lepenicës dhe ajo e Bratajt.

Lufta u zhvillua e rreptë, e pabarabartë, llogore më llogore, trup me trup. Dhe pas këtyre luftimeve të ashpra, forcat armike, pas dy ditësh, s'gjetën udhë shpëtimi veçse të dorëzonin armët. Të ashpra u bënë luftimet, sidomos duke u gdhirë data 6 qershor 1920, që vazhduan edhe natën deri më 7 qershor. Një sulm i tretë i rrufeshëm i detyroi forcat armike të bersalierëve dhe të alpinëve të dorëzoheshin. Më 7 qershor 1920 shkatërrohet garnizoni armik i vendosur në Llogara. U zunë 2 topa, 4 mitraloza, 70 robër, u vranë 20 ushtarë dhe u kapën armë, municione, veshmbathje dhe ushqime.¹ Nga forcat tona në luftën e Llogarasë u vranë komandanti i çetës

¹ AMH, VI, D. 35, 44, 47, 48.

së Lepenicës, Sheme Jazoja e të tjerë. Pati edhe të plagosur.

Marrja e Llogarasë ngriti më lart moralin e luftëtarëve vullnetarë, të cilët u prenë armiqtë të rrethuar çdo ndihmë ushtarake që mund t'u vinte nga Vlora.

CILIRIMI I MATONARAVAT DHE

TEPITIMET

Koncedohet Italiane e Qendrimit ne Vloze
Kishin venduar rreth e saj dhe ne Maton-
arave vone qendur jurem qvora dhe
Tepelone. Ne gjana e hulumtove te komiso-
nit nashat. te qetave vullnetare jale paze-
shkur edhe jale per shkurrimin e krunave
Italiane ne kete vend. Per kete qellim e caktoim
edbe forca qe do te jalonim per rrethim e
kesej qote nashat. Italiane jalem qe qe-
ndur kete me batalion komandant dhe me
batalion matore te perforcuar me armb te jale
spekiale. Per kete qellim jalem
Lufte ne bashkeshtetshme. Shkolle te rrethim
dhe ne kshire date 5 derisor 1930 dhe vazhdoi
qet shkolle date. Per kete qellim jalem qe qe-
vullnetare. vntand armik vuk rrethoi dhe qe
TERRA.

ÇLIRIMI I MATOHSANAJT DHE I TEPELENËS

Komanda italiane e pushtimit në Vlorë kishte vendosur trupat e saj edhe në Matohasanaj, vend që ndan kufirin midis Vlorës dhe Tepelenës. Në planin e luftimeve të komisionit ushtarak të çetave vullnetare ishte parashikuar edhe lufta për shkatërrimin e trupave italianë në këtë vend. Për këtë qëllim u caktuan edhe forcat që do të luftonin për marrjen e kësaj pozite ushtarake. Italianët kishin përqendruar këtu një batalion këmbësorësh dhe një bateri malore, të përforcuar me armë të tjera speciale¹.

Lufta në Matohasanaj filloi e rreptë natën, duke u gdhirë data 5 qershor 1920, dhe vazhdoi gati gjithë ditën. Nga sulmi i rrufeshëm i çetave vullnetare reparti armik nuk rezistoi dhe u dorëzua.

1 AQH i RPSSH, FL, VI, AMH VI, Dosjet 38-45.

Forcat vullnetare zunë këtu 131 robër. Midis oficerëve ishte edhe një major. U zunë 2 topa, 12 mitraloza, një sasi e konsiderueshme pushkësh, municione, veshmbathje dhe të tjera. Me marrjen e Matohasanajt përfundoi shkaktërimi i trupave italianë, që ishin vendosur jashtë qytetit të Vlorës dhe të Tepelenës.

Shumica e forcave vullnetare, që morën pjesë në luftën e Matohasanajt, shkuan në ndihmë të shokëve në Tepelenë, ndërsa një pjesë tjetër qëndruan në gatishmëri për të penguar përforcimet armike, të cilat mund të vinin nga Vlora.

Tepelena ishte një nga pikat e rëndësishme strategjike të pushtesve italianë. Rreth kështjellës ushtria armike kishte hapur llogore të shumta dhe kishte vendosur gardhe të lash me gjemba. Këtu ishin përqendruar trupa këmbësorie, karabinerie, reparte artilerie, mitraloza të rëndë dhe armë të tjera speciale. Në përforcim të kështjellës ishin dhe tri automobila.

Përballë kësaj fortese të përgatitur për një luftë të gjatë u zhvilluan përpjekje të përgjakshme. Në këto përpjekje morën pjesë çetat, që përbëheshin nga luftëtarët vullnetarë të fshatrave Mezhgoran, Dragot, Beçishtër, Kashisht, Arrëz e Vogël, Arrëz e Madhe, Lekël, Maricaj, Hormovë, Kodër, Luzat, Bënç, Veliçot, Turhan, Dukaj, Memaliaj. Kishte vullnetarë nga qyteti i Tepelenës, nga krahina e Kurveleshit të Sipërm dhe nga rrethet Përmet, Skrapar, Gjirokastër.¹ Numri i luftëtarëve vu-

¹ AMH, VI, Dosja 50.

lletarë, që rrethuan kështjellën e Tepelenës, ishte rreth 1000 veta¹.

Për marrjen e Kështjellës së Tepelenës sulmi filloi më 5 qershor 1920.

Komanda ushtarake italiane në Vlorë, për t'i ardhur në ndihmë garnizonit të Tepelenës, në mëngjesin e 8 qershorit 1920 dërgoi dy batalione bersalierësh, por kjo ndihmë nuk arriti pasi rrugët ishin të zëna nga çetat kryengritëse. Të dy batalionet armike u sulmuan në afërsi të Qishbardhës dhe pasi lanë shumë të vrarë, u detyruan të kthehen në Vlorë. Luftëtarët shqiptarë zunë në Tepelenë 870 ushtarë robër, 70 oficerë, midis tyre një major, 4 topa, 330 pushkë, 6 mitraloza, 3 autoblanda, 25 aparate telefonike, 2 aparate telegrafi, 32 karro, 35 mushka dhe kuaj, shumë arka me municione, fishekë e predha artilerie dhe disa automjete ushtarake.² Më 21 qershor ushtarët e garnizonit armik të Tepelenës, të rrethuar në kështjellë dhe të ndodhur nën goditjet e gjithanshme të atdhetarëve, që u kishin prerë edhe furnizimin me ujë, u detyruan të ngrinin flamurin e bardhë dhe të dorëzoheshin.

Çetat vullnetare, që morën pjesë në luftimet e fazës së parë, ishin kryesisht nga rrethet Vlorë e Tepelenë. Zhvillimi i luftimeve në këtë fazë pati disa tipare të veçanta. Një ndihmë të madhe dha edhe Qeveria Kombëtare e Tiranës, e cila fshehurazi organizoi edhe dhënie të ndihmës në Luftën e Vlorës.

Fitoret e fazës së parë i shkaktuan armi-

1 Gazeta «Koha», Korçë, 10 korrik 1920, AMH, VI. Dosjet 36, 50. AMH, të Gjirokastrës etj.

2 Gazeta «Drita», 23 qershor 1920. Revista «Përparimi», qershor 1920.

kut dëme të mëdha në njerëz dhe në armati-
me. Ata lanë në fushën e luftës 120 të vrarë,
1609 robër, midis tyre dy kolonelë dhe 100 ofi-
cerë si dhe 1000 të plagosur. U zunë 1000 kuaj
e mushka, ilaçe, veshmbathje, ushqime. U ka-
pën 15 topa, 88 mitraloza, 3 autoblanda, 330
pushkë, 1000 kasa me municione, 25 aparate
telefonike, dy aparate telegrafike, etj., me të cilat
u pajisën luftëtarët shqiptarë.¹

Rëndësia e fitoreve të para dhe jehona e
tyre në Shqipëri ishte e madhe. Këto fitore
ishin një goditje e rëndë jo vetëm për koloni-
zatorët imperialistë italianë, por edhe për agje-
nturën e tyre në vendin tonë, për qarqet feu-
do-borgjeze proitaliane, që ndiqnin një politi-
kë kapitulluese e tradhtare.

Lufta e Vlorës gjeti përkrahje edhe në qar-
qet përparimtare jashtë vendit, sidomos në pro-
letariatit italian, i cili e dënoi politikën gra-
bitqare imperialiste ndaj Shqipërisë. Kundër
agresionit në Shqipëri u bënë protesta e demon-
strata të shumta. Në Trieste, në Ankona, në
Bari, në Brindizi etj. u afishuan thirrje të Par-
tisë Socialiste, që i ftonin ushtarët të mos pra-
nonin të shkonin në Shqipëri. Më 26 qershor
repartet e bersalierëve në Ankonë i bënë që-
ndresë urdhrin të qeverisë dhe komandës italiane
për të shkuar në Shqipëri. Deputetët sociali-
stë italianë kërkuan në parlament që të largo-
heshin trupat italiane nga Shqipëria.

Një përkrahje e madhe për Luftën e Vlorës
ishte solidariteti i madh atdhetar i krahinave

¹ AQH i RPSSH, Fondi «Lufta e Vlorës», Dok. 38
original, Dosja L. VI. dok. nr. 35, kopje, AMH, VI, FL,
VI. 1920, dok. nr. 30-42, 47. Gazeta «Drita», 23 qershor
1920. Revista «Përparimi», qershor 1920.

të vendit. Fitoret e para në frontet e luftës bë-
në përshtypje në Shqipëri. Krahinat e shprehmin
këtë jo vetëm me mitingje, me letra e me telegra-
me, por edhe me grumbullimin e ndihmave mate-
riale në ushqime, në veshje, në ilaçe etj., si dhe
me dërgimin e forcave vullnetare.

Lufta e Vlorës gjeli përkrahje edhe në gar-
det përpunimtare jashtë vendit sidomos në pro-
letarë të Italisë, i cili e bëri politikën ma-
tërisht imperialiste ndaj Shqipërisë. Krah-
ësionit në Shqipëri u bë në protestë e llog-
nërisht të shprehur në Tiranë në Arkonë në
Janar në Prinditë etj. u shprehuan thirrjet të Par-
tisë Socialiste që i tregoi unitet që të mos gra-
monin të ankohin në Shqipëri. Në 28 gershor
repatit u përshpreh në Arkonë i bënë de-
ndresë udhëtoi të përshpreh dhe komandës italiane
gjatë shkollës në Shqipëri. Dërguesit sociali-
stë italianë kërkuan në parlament që të largo-
hejshin trupat italiane nga Shqipëria.
Një përkrahje e madhe për luftën e Vlorës
ishte solidariteti i madh shqiptar i krahinave

1920. Revista «Përpunimi», gershor 1920.
VI. 1920, dok. nr. 30-42. «Gazeta «Drita», 28 gershor
Origjinal. Dotsja L. VI. dok. nr. 35, kopje AMH, VI. 41.
I AGH «PËRSHI, Fondat «Lalla e Vlorës», Dok. 38

FAZA E DYTË E LUFTIMEVE

(11 qershor — 1 shtator 1920)

LUFTA PËR ÇLIRIMIN E VLORËS

Në luftën për çlirimin e Vlorës (faza e dytë) morën pjesë jo vetëm Vlora, Tepelena dhe Kurveleshi, por edhe Mallakastra, Berat, Skrapari, Gjirokastra, Përmeti, Korça, Elbasani, Tirana, Dibra, Shkodra e shumë qytete të tjera. Ajo ishte një luftë e tërë popullit shqiptar.

Çetat që morën pjesë për çlirimin e qytetit të Vlorës ishin të vendosura sipas planit të mëposhtëm:

Çeta e Sevasterit kishte zënë vend në Qafë të Koçit nga ana jugore; çeta e Tragjasit, në Vreshtat e Mëdha; në vazhdim të çetës së Tragjasit ishte ajo e Vermikut e bashkë me to, në Babiçë të Madhe, u përqendrua edhe çeta e Gorishtit. Çeta e Kurveleshit të Sipërm lu-

ftoi në anën veriore të Qafës së Koçiut. Në qendër të fortesave të mbrojtjes së ushtrisë italiane, në Qafë të Koçiut, zuri vend çeta e Salarisë. Çeta e Mavrovës, së bashku me luftëtarë të Kropishtit, që ishin inkuadruar, në të, u përqendrua mbi Gropën e Derrit. Në kufi me këtë ishin luftëtarët e çetës së Karbunarit, që u përqendruan në Babicë të Vogël. Luftëtarët e Peshkëpisë u vendosën në Bestrovë, ata të Treblovës dhe çeta e Kurveleshit të Poshtëm në lindje të Bestrovës. Çeta e Smokthinës u përqendrua kryesisht në Sherishta, një pjesë e saj në Babicë të Madhe dhe në Xhuherinë. Luftëtarët e Shkozës hynë në çetën e Sevasterit dhe zunë vend në jugperëndim të Bestrovës. Çeta e Gjormit luftoi në juglindje të Bestrovës. Këtu luftuan një pjesë e vullnetarëve të Mavrovës. Çeta e Mallakastrës së Sipërme zuri vend në majat e Risilisë, nga ana perëndimore, deri në kufi me çetën e Kurveleshit të Poshtëm. Çeta e Mallakastrës së Poshtme dhe ajo e Topalltisë u përqendruan nga ana perëndimore e Bestrovës deri në kufi me detin Adriatik. Në bregoret Panaja—Hoshtimë ishin luftëtarët e Progonatit. Këto çeta shtriheshin në thellësi të pozicioneve të tyre nga juglindja, nga lindja, nga veriu, nga veriperëndimi i qytetit të Vlorës, duke u përqendruar në kodrat e Sherishtës, të Xhuherinës, të Risilisë, të Çepratit, të Kërkovës, të Heshtimës e të Panajasë.¹

Para 10 qershorit këto vende ishin në duart e ushtrisë italiane. Një pjesë e mirë e çetave

1 FAMH, VI, D. 35, 36, 38, 45, 46, 58. Lufta pas sulmit të 11 qershorit bëhej me ndërprerje, një pjesë e çetave pushonin në thellësi të frontit të tyre, kurse një pjesë qëndronin e luftonin në vijën e parë të frontit.

vullnetare kishte zënë vijën e frontit Babicë—
—Hoshtimë—Panaja, duke u futur gjer në thel-
llësi afër Bestrovës, qysh me datën 8 qershor
1920. Po, në këtë datë ushtarët italianë ishin
larguar nga ura e Vjosës, duke lënë pozicio-
net bashkë me një sasi veshjesh dhe mjetesh
të tjera luftarake.

Komanda italiane në Vlorë, menjëherë pas
disfatave të ditëve të qershorit, filloi të marrë
masa mbrojtëse. Qysh në mëngjesin e datës
6 qershor 1920 në qytetin e Vlorës u shpall gje-
ndja e luftës. Filluan arrestimet në masë. Bre-
nda dy ditëve të para u arrestuan 1400 veta, të
cilët u internuan në ishullin e Sazanit dhe pje-
sërisht u mbyllën në bodrumet e një anijeje.
Sazani u kthye në një ishull përqendrimi, ku
torturoheshin atdhetarët. Filluan djegiet, vje-
dhjet dhe plaçkitjet në shtëpitë e qytetarëve
vlonjatë.

Komanda ushtarake e pushtimit italian në
Vlorë, duke parë disfatën në luftimet e fazës së
parë, mori masa të jashtëzakonshme për mbroj-
tjen e qytetit.

Më 6 qershor 1920 forcat ushtarake italia-
ne ishin vendosur në një vijë fronti prej 27 km,
që rrethonte qytetin si dhe Kaninën, duke zënë
mbrojtjen nga Jonufër—Kanina deri poshtë
në brigjet e Mesovunit, të Babicës së Madhe,
të Babicës së Vogël, të Bestrovës, të Panajasë,
të Nartës dhe të Zvernecit. Në mbrojtje ishin
vendosur reparti i 85-të dhe 86-të i fanteri-
së së brigadës «Verona», ndërsa katër batalione
të grupit të dytë alpin dhe bateria malore e
grupit të 50-të të artilerisë qenë ngarkuar në
këtë vijë fronti për t'u mbrojtur nga sulmet
e vullnetarëve shqiptarë, që do të luftonin për
çlirimin e Vlorës. Më 10 qershor në Vlorë arriti

brigada «Piacenza», që të përforconte trupat në frontin e luftës.

Komanda ushtarake italiane kërkoj nga qeveria e Romës përforcime të reja për të përballuar sulmet e luftëtarëve shqiptarë dhe për të mbajtur të pushtuar Vlorën. Ushtarët italianë punonin ditë e natë për ndërtimin e llogoreve. Qyteti u rrethua me llogore dhe me tri palë gardhe me tela me gjemba, me fortesa të shumta, ku ishin vendosur topa dhe mitraloza. Artileria, autobлиндat dhe tanket ishin në gjendje gatishmërie; ato prisnin vetëm sinjalet e sulmit. Prozhektorët e vaporëve italianë gjithë natën ishin në veprim, kontrollonin vendet përreth Vlorës. Brenda në qytet komanda italiane organizoi patrulla të armatosura, të cilat ndodheshin gati në çdo rrugë dhe në çdo kthesë. Rrugët ishin të mbyllura. Qarkullimi i popullsisë qytetare ishte i ndaluar. Patrullat ushtarake mbillnin panik dhe kryenin akte terrorizmi. Kjo ishte gjendja e qytetit të Vlorës para datës 11 qershor 1920. E megjithatë, në këto rrethana shumë atdhetarë vlonjatë kalonin përmes rojave të ushtrisë italiane dhe bashkoheshin me luftëtarët vullnetarë shqiptarë, që kishin rrethuar qytetin.

Më 9 qershor, para se të fillonte sulmi mbi qytet, Komiteti i Mbrojtjes Kombëtare, me qendër në Drashovicë, i dërgoi ultimatumin e dytë komandës ushtarake të forcave italiane të pushtimit në Vlorë, në të cilin bëhej fjalë për sukseset e korrura gjatë fazës së parë të luftimeve, për sjelljet kriminale të ushtrisë italiane kundrejt popullsisë së pafajshme e tjera. Në këtë ultimatim jepej paralajmërimi i fundit, ku midis të tjerash thuhej: «Ne nuk dëshirojmë të hapim një konflikt gjakësor ndërmjet italianëve dhe shqiptarëve, nuk dëshirojmë

të lëmë një kujtim të paharrueshëm midis dy kombeve, por të drejtat tona të shenjta na shtrëngojnë të mbrojmë atdheun tonë të dashur kundër çdo force të tmerrshme që do të gjejmë përpara...

Me këtë duam të vëmë në dijeni se për një kohë të shkurtër do të jemi zotër të Vlorës... prandaj ju lutemi dhe një herë të lironi Vlorën për të mos shkaktuar shkatërrimin e plotë të qytetit dhe të ushtarëve tuaj të pafajshëm, përgjegjësia për të cilën do të jetë vetëm e juaja».¹

Por komanda italiane, me gjithë disfatat që kishte pësuar, vazhdonte ta nënvleftësonte fuqinë e luftëtarëve vullnetarë dhe nuk u përgjigj. Ky fakt tregoi se ajo nuk kishte ndërmend ta lironte Vlorën pa luftë. Komiteti i Mbrojtjes Kombëtare, në bazë të planit të luftimeve që ishte hartuar më parë, duke u mbështetur në heroizmin, në trimërinë e pashoqe dhe në dëshirën e zjarrtë të luftëtarëve, lëshoi urdhrin e sulmit mbi Vlorë dhe Kaninë, duke u gdhirë data 11 qershor 1920 në orën 2⁰⁰.

Lufta filloi në Qafën e Koçit dhe brenda disa minutave u përhap në tërë frontin që kishin zënë luftëtarët shqiptarë. Pasi kaluan, duke vendosur mbi telat me gjemba gunat, prenë gardhet me gërshërë dhe hynë në thellësi të mbrojtjes së armikut. Luftëtarët e çetës së Salarisë, me në krye komandantin e çetës Heroin e Popullit Selam Musanë dhe zëvendëskomandantin Dule Dalanin përparuan deri te spitali. Italianët ishin vendosur në pozita tepër mbrojtëse. Por Selam Musai, në ballë të luftëtarëve, midis fërshëllimës së plumbave, çau drejt po-

1 AQH. i RPSSH, FI. VI, Dosja nr. 3, dt. 9.6.1920.

zicioneve, duke u përleshur me armikun. Luftëtarët që e shoqëronin hap pas hapi përparonin në kushte shumë të vështira e të pabarabarta. Përballë tyre qëndronin forca të shumta të armikut, të cilat herë pas herë hidheshin në kundërsulme.

Salariotët trima u gjendën midis dy zjarreve. Plumbat u binin nga të gjitha anët, dritat e prozhektorëve i ekspozonin para armikut. Megjithëkëtë ata nuk e humbën gjakftohtësinë, por duke manovruar pas çdo ledhi e pas çdo tringu, mundën t'i shpërngulnin ushtarët armiq nga pozicionet e zëna.

Selam Musai u fut midis formacioneve të ushtarëve armiq e po përleshje me ta. Një oficer italian i ktheu pushkën e po bëhej gati t'i zbraste në gjoks, po Selami vetëtimthi iu hodh dhe i nguli thikën në grykë.

Ja si e paraqet kënga popullore këtë skenë:

*«O Selam, o trim i rrallë,
Te ullahtë mbi spitalë
Zure një mareshal të gjallë
I preve kokën me pallë.»*

Bashkë me Selamin luftonin edhe Dule Dalani, Ibrahim Muçaj, Shefqet Shehu e shumë të tjerë.

Duke vepruar me trimëri e duke manovruar me guxim, çeta e Salarisë u fut brenda formacioneve të reparteve të ushtrisë italiane dhe mbërriti mbi qytet. Lufta u bë e rreptë, vendi u ndez tym e flakë, dëgjohej zëri i Selamit: «Para, o shokë t'i hedhim italianët në det!». Dhe në këtë betejë të përgjakshme vritet Selam Musai.

Bukur i këndon kënga labe heroizmit të tij:

«Të vranë o Selam të vranë,
Në Babicë mbi hapsanë,
Në qafë që sheh limanë,
Shtatë djem t'u ndodhë mbanë,
Shtatë djem zemërçelik
S'tu ndanë sa u the ikë,
Kurrë mos i zëntë e ligë.»

Selam Musai ishte ai që kishte propaganduar në popull luftën për çlirimin e Vlorës, madje këtë e pasqyron qartë edhe kënga popullore:

«Kur ishte maji njëzetë
I mblodhi Selami djemtë.
Djemtë i mblodhi Selami:
— O djem se iku vatani
Na zaptoi italiani,
Vlorën me gjak ta lani,
se kështu mbrohet vatani.»

Vdekja e Selamit¹ ishte po aq heroike sa dhe jeta e tij në dobi të atdheut dhe të popullit.

1 Selam Musai lindi në vitin 1860 në Salari të rrethit të Tepelenës. Shërbimin ushtarak e kreu në Jemen, ku qëndroi gjashtë vjet. Mori pjesë në radhët e forcave atdhetare, që drejtoheshin nga një komitet i formuar më 1905, në Tepelenë dhe që luftonin kundër push-tuesve turq. Pas Hyrjetit (1908) ai mbante lidhje të ngushta me çetën e Çerçiz Topullit dhe me atë të Nazif Hadërit.

Më 1911 u zgjodh komandant i çetës së fshatit Salari, e cila qëndronte në gatishmëri për të luftuar kundër turqve. Mori pjesë në luftën e Janinës, në nëntor 1912, kundër forcave ushtarake greke ku edhe u plagos për të dytën herë në kokë dhe në këmbë: Shpallja e Pavarësisë e gjeti në fushën e betejave për mbrojtjen e ku-

Ai që u shqua qysh në vitet e para të Shpalljes së Pavarësisë, sidomos në vitin 1912, po ashtu u shqua në vitin 1914 në luftën kundër ushtrisë pushtuese greke dhe kryesisht në vitin 1920, në Luftën e Vlorës. Por trupi i tij nuk u gjet. Edhe këtë akt populli e përjetësoi në këngët e veta:

*«... Koloneli me zabinë,
Me dorë dot nuk të zijtë,
Të hodhën flakë e benzinë,
Trupin e mishnë ta zhurinë.»*

Në çastet kur u hodh në sulm Selami, nga ana e majtë e tij, në thellësi të mbrojtjes së armikut, në përleshje e sipër, ranë në fushën e betejës: Rexhit Birçe, Pasho Karafili, Xhafer Islami, nga Sevasteri, Myrteza Selimi nga Gollimbasi, Qendro Fega nga Dushkaraku e të tjerë.¹

Afër mëngjesit lufta u bë më e ashpër, tokë e qiell u përflakën. Në gjithë vijën e frontit vullnetarët u hodhën në sulm. Në mëngjesin e datës 11 qershor 1920 vullnetarët shqiptarë, të bashkuar me atdhetarët vlonjatë, luftonin nëpër dritare, nëpër ballkone në tarracat e shtëpive.² E ndërsa ata përparonin në thellësi të qytetit, pushtuesit strukeshin në skelë.

Në Vlorë gjendja vazhdonte të ishte kritike për pushtuesit. Një gazetar italian telegra-

fijvë të Jugut. Më 1914 mori pjesë në luftimet kundër pushtuesve grekë në malin e Gribës dhe në Labovë, ku u plagos në gjoks. Ishte anëtar i Komitetit të Mbrojtjes Kombëtare të Tepelenës.

1 AMH, VI. D. 32, 38, 41 e tjera.

2 AMH, VI. D. 30, 37, 38.

fonte nga Vlora: «Po jetojmë orë të tmerrshme. Të ngjethet mishi nga pamja e vetmuar e qytetit. Disa thonë se kryengritësit janë 5 000 veta, të tjerë thonë 10 000, por asgjë nuk dihet e sigurt. Është e pamundur të vërtetosh shumën e saktë të humbjeve tona dhe ato të kryengritësve».

Krejt ndryshe ishte morali i popullit shqiptar dhe i luftëtarëve të tij. Prefekti i Beratit, i cili vizitoi ato ditë vendet ku zhvilloheshin luftimet, i raportonte Ministrisë së Punëve të Brendshme, më 17 qershor 1920: «Morali i popullit është në një gradë shumë të lartë. Edhe fëmijët e gratë nuk hiqen nga marrja pjesë në këtë luftë, duke thënë se shpirti i qeverisë është Vlora».¹

Në ndihmë të vullnetarëve ishin edhe gratë, të cilat kujdeseshin për të vrarët dhe të plagosurit, për të ndihmuar frontin në furnizimin me municion, me ushqime e të tjera. Pjesëmarrjen e gruas në Luftën e Vlorës e dëshmon edhe kënga popullore:

*«Të plagosurit rënkojnë,
Le të dalim dhe ne gratë,
Me hanxharë e me sëpatë,
Të marrim peshqir e napë,
T'u njomim buzën e thatë,
Dhe t'u lidhim ato plagë,
T'u sjellim bukë e dyfekë
Et t'u hapim hendekë.»*

Gjithë punën në prapavijë, për sa u përket furnizimeve me ushqime, me municione luftarake, me veshmbathje e të tjera, e bënin gratë,

¹ AQH, i RPSSH, Fl. VI, nr. 19091.

lufta e të cilave ndihmoi drejtpërdrejt në fitoren e Luftës së Vlorës, më 1920.

Më 16 qershor 1920 Komiteti i Mbrojtjes Kombëtare i dërgoi komandës italiane një notë, ku protestonte kundër vrasjeve, masakrave, torturave dhe krimeve të tjera barbare të ushtarëve italianë. Një notë e tillë iu dërgua edhe Fuqive të Mëdha: Anglisë, Francës dhe Shtetëve të Bashkuara të Amerikës,¹ por ato si gjithnjë, nuk treguan asnjë kujdes për çështjen shqiptare. Rrethi i Vlorës dha për luftën 10 për qind të bagëtive për çdo kope. Disa kope të Vlorës u vunë krejtësisht në dispozicion të luftëtarëve të frontit.²

Përsëritje të zjarra iu dërguan luftëtarëve nga të gjitha anët e vendit. Në Elbasan u mbajt, më 30 qershor 1920, një miting i madh, në të cilin morën pjesë edhe shumë fshatarë. Nga mitingu iu dërgua kryetarit të Konferencës së Paqes në Paris një rezolutë, ku shfaqej solidariteti i popullit të rrethit të Elbasanit me luftëtarët e Vlorës.³ Mitingje të tilla u organizuan në Korçë dhe në qytete të tjera.

Në Luftën e Vlorës u bënë edhe disa dallime të tjera klasore: shumë nga bejlerët dhe nga agallarët, elementë të tjerë të lidhur me interesa politike dhe ekonomike me pushtuesit, pseudoatdhetarë dhe agjentë të shitur tek italianët, iu kundërvënë kësaj lufte të shenjtë. Komiteti i Mbrojtjes Kombëtare kishte krijuar edhe gjyqin ushtarak, i cili mori disa vendime të drejta për t'u dhënë dënimin e merituar tradhtarëve. Kështu, për shembull, u mor

1 AQH, i RPSSH, FL, VI, nr. 51254, kopje.

2 AMH VI, FL, VI, dosje 47.

3 AQH i RPSSH, nr. 51271.

vendim që Eqrem bej Vlora, për veprimtarinë e tij armiqësore e antikombëtare, të dënohej me vdekje.

Gjyqi ushtarak gjykoi në mungesë dhe dënoi me vdekje Qamil Risilinë, Seit Qamilin dhe Siri bej Vlorën. Mirëpo këto vendime nuk u zbatuan pasi midis anëtarëve të Komitetit të Mbrojtjes Kombëtare nuk kishte unitet mendimi, gjë që dëshmon për kufizimet klasore e për pavendosmërinë e krerëve borgjezë për t'i çuar këto vendime të drejta deri në fund.

DREJTIMI I KUNDËROFTARISË ARMIKE

Me 18 gershor 1920 informatorët e armimit dhe postës informuan e gjeneral Përcinini. Përkës Komitetit i Mbrojtjes Kombëtare e ho- dhëne përgjigje kundëroftarisë me qyqën e moshës e këllj informuanit u përgjigjen për t'i luftuarët shpirtërisht, të vëmendur nga për- të kohës; janë logj avistacion etj. ushtarake, pajtje e armatime nga të modernet 1920, bërgol në përbetën shpirtërisht forca të reja Khorani Xhorrit që erdh në fadi në peshor për këtë qëllim, çevera e re e Romës e aive ndërkrimoret.

Me 18 gershor 1920 informatorët e armimit dhe postës informuan e gjeneral Përcinini. Përkës Komitetit i Mbrojtjes Kombëtare e ho- dhëne përgjigje kundëroftarisë me qyqën e moshës e këllj informuanit u përgjigjen për t'i luftuarët shpirtërisht, të vëmendur nga për- të kohës; janë logj avistacion etj. ushtarake, pajtje e armatime nga të modernet 1920, bërgol në përbetën shpirtërisht forca të reja Khorani Xhorrit që erdh në fadi në peshor për këtë qëllim, çevera e re e Romës e aive ndërkrimoret.

DËSHTIMI I KUNDËROFENSIVËS ARMIKE

Më 16 qershor 1920 komandanti i forcave pushtuese italiane në Vlorë, gjeneral Piacentini, i dërgoi Komitetit të Mbrojtjes Kombëtare një ultimatum, në të cilin u kërkonte kryengritësve që të hiqnin dorë nga lufta brenda 24 orëve, të dorëzonin armët si dhe robërit italianë, sepse në të kundërtën do të fillonin një kundërofensivë ndëshkimore.¹

Për këtë qëllim, qeveria e re e Romës e Xhovani Xholitit, që erdhi në fuqi në qershor 1920, dërgoi në bregdetin shqiptar forca të reja ushtarake, pajisje e armatime nga më modernet të kohës: tanke, topa, aviacion etj.

Luftëtarët shqiptarë, të zemëruar nga përmbajtja e këtij ultimatumit, u përgatitën për t'i dhënë përgjigje kundërofensivës me grykën e pushkës. Komiteti i Mbrojtjes Kombëtare e hodhi poshtë ultimatumit e gjeneral Piacentinit.

Më 18 qershor 1920 informatorët e armikut

¹ Historia e Shqipërisë, vëll. 3, Tiranë 1984, f. 229.

i kishin çuar lajmin komandës italiane se shumë nga luftëtarët shqiptarë, kishin shkuar në shtëpitë e tyre dhe se forcat vullnetare në vijën e frontit ishin të pakta. Komanda italiane e pa me vend të përfitojë nga këto rrethana dhe po në atë datë purdhëroi fillimin e kundërofensivës së gjerë. Komandanti i përbashkët i forcave të armatosura italiane, që do të fillonte kundërofensivën, ishte gjeneral Pulieze. Kështu, duke u gdhirë 18 qershori, ushtria armike filloi sulmin nga mali i Shashicës, me qëllim që t'u merrte krahët çetave të cilat luftonin për marrjen e Kalasë së Kaninës dhe ta vinte Drashovicën, këtë pikë të rëndësishme komunikimi, midis dy zjarreve. Por kjo nuk u realizua, mbasi në mbrojtje të Shashicës ishin caktuar çeta, të cilat qëndronin kurdoherë në pritje të një kundërsulmi nga ushtria italiane. Në drejtim të Drashovicës kundërsulmuan batalione arditësh,* barsalierësh, reparte artilerie, tanke dhe autoblanda. Bateritë e luftanijeve filluan zjarrin kundër pozicioneve të vullnetarëve të fshatrave të çliruara, si Drashovica, Tragjasi, Dukati, Radhima e tjera. Aeroplanët filluan të mitralonin mbi vijën e frontit të luftëtarëve shqiptarë si dhe mbi popullsinë e pafajshme të fshatrave përreth Vlorës.

Forcat ushtarake italiane iu afruan Sherishtës, ku u ndez një luftë e rreptë. Çetat luftëtare vullnetare në Sherishtë, të radhitura dhe të vendosura në pozicionet e luftës, sulmuan papritur. Filluan sulmet mbi arditët dhe bersalierët në tërë frontin. Në këtë betejë nga pala italiane pati shumë humbje të rënda: u vranë mbi 200 italianë. Pas disa orë luftimesh repartet italiane u thyen dhe u detyruan të kthehen në Vlorë. Më

* Arditë (ital.), ushtarë të reparteve sulmuese.

datën 19 qershor komanda italiane dërgoi në drejtim të Penkovës, tri batalione këmbësorësh dhe një batalion alpinësh. Ato u pritën nga forcat vullnetare dhe u ndalën që në Babicë të Madhe. Artileria, që ishte në malin e Kaninës (Shashicë), në sheshin e shkallës, dhe që komandohej nga Abdurahman Çiraku, godiste në drejtim të vaporit «San Marco», me qëllim që ta detyronte t'i ndërpriste bombardimet në pozicionet e luftëtarëve vullnetarë.

Batalionet armike filluan kundërsulmin për të zbuluar pozicionet e luftëtarëve të forcave vullnetare në grykën e Shushicës si dhe në malin e Shashicës. Nga ana tjetër, ata mendonin që të godisnin dhe të shkatërronin qendrën e drejtimit të forcave luftëtare vullnetare në Drašovicë. Në bombardimet e artilerisë armike morën pjesë gjithashtu torpedinierët dhe kaciatorpedinierët, që qëllonin në vijën e frontit të luftëtarëve shqiptarë. Zjarri i madh u bë nga armiku në Babicë. Një kompani e fanterisë 96 e brigadës «Udine», e mbështetur nga 6 autoblanda, kundërsulmoi në drejtim të Babicës. Por armiku nuk mundi të shkojë më tutje, pasi ndeshi në rezistencën e luftëtarëve tanë. Në drejtim të Babicës armiku hodhi dhe Batalionin e 4-t Alpin, kurse Batalioni i 9-të mbërriti në afërsi të Sherishtës, ku ata u gjendën të rrethuar dhe u shkatërruan nga sulmet e forcave kryengritëse. Në këto luftime morën pjesë dhe dy aeroplanë (SVA). Më 23 qershor 1920 luftëtarët vullnetarë rrëzuan një aeroplan në afërsi të Peshkëpisë, piloti i të cilit, duke u përpjekur që të shpëtonte, u hodh nga aeroplani dhe u vra. Pas rrëzimit të aeroplanit u nisën nga Vlora disa autoblanda kundër çetave që kishin zënë vijën e frontit, në pjesën lindore të Vlorës. Në afërsi të Qishbar-

dhës forcat luftëtare në këto rajone u hapën zjarr autoblivdave. Luftëtarët u përleshën me to dhe i detyruan të kthehen pa e mbushur misionin e tyre luftarak. Njëra prej tyre u dogj. Nga luftëtarët pati 4 të plagosur dhe një të vvarë. Në këtë kohë italianët mbetën të mbyllur në qytetin e Vlorës.

Populli shqiptar, i indinjuar nga kjo ofensivë e gjerë e ushtrisë pushtuese italiane, e shumëfishoi ndihmën moralo-ekonomike-financiare-ushtarake për luftëtarët vullnetarë shqiptarë.

Në Shijak shkuan përfaqësues të qeverisë së Tiranës, të cilët organizuan një mbledhje, ku u vendos: të ndihmohej aktivisht lufta e Vlorës;¹ të niseshin vullnetarë nga Shijaku dhe nga Tirana.² Në Elbasan Komiteti i Mbrojtjes Kombëtare organizoi një fushatë të gjerë për të ndihmuar Luftën e Vlorës, duke grumbulluar armatime. Nga Elbasani u dërguan në Vlorë 43 arka me municione, nga Gramshi 15000 fishekë, nga Pogradeci 40 arka me municione etj. Për ndarjen e municionit nëpër vijën e frontit u formua në Selenicë (Vlorë)³ një karvan prej 40 mushkash, i cili merrej edhe me transportimin e drithit e të bukës për në front.

Komitetet e Mbrojtjes Kombëtare vepronin po në këtë mënyrë edhe në Tiranë, në Përmet, në Berat, në Fier, në Shkodër, në Dibër etj. Nga Korça erdhën në Vlorë 150 luftëtarë vullnetarë. Vullnetarë erdhën edhe nga Shqipëria e Veriut, kurse nga Gjirokastra 150 veta me kryetar Kapo

1 AQH, i RPSSH, Fl. VI, nr. 109, dt. 25.7.1920.

2 Po aty, nr. 3145, datë 28.6.1920.

3 Po aty, Shkresë nga Elbasani drejtuar MPB, Tiranë, 19.6.1920. Po aty, nr. 663/30, Po aty, 8.7.1920 e tjera.

Topullin dhe zëvendës Hasan Xhikun¹. Nga Elbasani, nga Gramshi, nga Peqini e nga Librazhdi erdhën 300 luftëtarë nën komandën e Xhemi Misës. Populli i qyteteve dhe i krahinave të ndryshme të Shqipërisë e ndihmoi Luftën e Vlorës para fillimit dhe gjatë zhvillimit të saj duke përfshirë qytete e rrethe si: Shkodra, Shëngjini, Kastrati, Kruja, Përmeti, Elbasani, Berati, Skrapari, Shijaku, Tirana, Pogradeci, Korça, Kolonja, Bilishti, Tepelena, Gjirokastra Fieri, Kavaja, Peqini, Mati, Dibra e të tjerë². Ndihma të shumta u mblodhën kudo për luftëtarët. Vetëm në Berat dhe në Gjirokastrë u mblodhën rreth 100000 franga ari³. Populli i Kolonjës dërgoi në Vlorë më tepër se 300 desh⁴. Me gjithë terrorin e madh të armikut, populli i qytetit të Vlorës mblodhi 57000 lireta për të ndihmuar luftën⁵. Populli i rrethit të Elbasanit dërgoi në ndihmë të luftëtarëve të Vlorës më tepër se 250 napolona ar⁶. Kolonja dërgoi 11000 okë grurë⁷, Kurveleshi 2000 krerë bagëti, Korça 800 krerë bagëti.

1 AMH VI Dosja 44. Shkresë e prefektit të Elbasanit dërguar Tiranës më 8.8.1920. Gazeta «Drita», 9.6.1920. Revista «Nëntori» nr. 8, viti 1960.

2 AQH i RPSSH, F.L. i parlamentit. Bisedim në Kësh. Komb., f. 20.

3 AQH i RPSSH, FL VI. (Shkresë nga MPB, Tiranë, dërguar prefektit të Vlorës).

4 Gazeta «Mbrotjtja kombëtare», 20 shkurt 1921.

5 Po aty.

6 AQH i RPSSH, FL VI. (Shkresë e pref. Elbasan dërguar MPB Tiranë, 8.7.1920).

7 Gazeta «Koha», Korçë, 7.8.1920.

ÇLIRIMI I KANINËS

Nga data 6-10 qershor 1920 një pjesë e forcave kryengritëse shqiptare qëndroi në malin e Shashicës, në vendin e quajtur Marko dhe Frëngovec. Çetat luftëtare, që qëndronin në Shashicë, ishin: ajo e Kaninës, me komandant Beqir Velon, e Vranishtit me komandant Sali Muratin, e Tërbaçit me komandant Selman Hysenin, e Bratajt me komandant Memo Meton, si dhe ajo e Velçës, e Bolenës, e Gumenicës, e Tragjasit dhe e Dukat-Radhimës¹. Në malin e Shashicës, në sheshin e Shkallës, ishte vendosur një top, i cili mbrohej nga 30 luftëtarë tërbaças. Pjesa më e madhe e çetës, që komandohej nga Selman Hyseni, qëndronte në mbrojtje të Shashicës. Për shkak të raprezaljeve, të plaçkitjeve, të vjedhjeve etj., populli i Kaninës ishte shpërngulur dhe shtëpitë i kishte braktisur. Në Kaninë ishte

¹ AMH VI, 30, 32, 36, 37, 41, 48. Çetat Dukat-Tragjas-Radhimë erdhi në Shashicë në datën 8.VI.1920.

vendosur një bateri malore italiane. Në kala dhe në afërsitë e saj ishin vendosur arditët.

Për rrethimin e Kalasë¹ së Kaninës u hartua një plan i posaçëm. Sipas tij, nga ana jugore u vendos çeta e Kaninës, nga ana veriore ajo e Vranishtit, e cila përforcohej nga ana perëndimore me çetën e Kaninës, nga ana lindore u vendosën çetat e Bolenës, të Kallararit, të Velçës, të Gumenicës, të Bratit, kurse çetat e Tërbaçit, të Dukatit, të Tragjasit dhe të Radhimës qëndruan në malin e Shashicës. Një pjesë e çetave ishin si forcë rezervë e luftëtarëve kryengritës. Në Shashicë, në Marko, komandantët e çetave që luftuan në Kaninë u mblodhën dhe, pasi kuvenduan, vendosën këto detyra:

- a) Ndarja e çetave në tri grupe.
- b) U caktuan vendet e luftimit.
- c) U caktuan rrugët e kalimit.
- ç) U caktuan sinjalet e fillimit të sulmit.
- d) U caktua forma e furnizimit me ushqime dhe të tjera. Lufta për marrjen e kalasë ishte shumë e vështirë, pasi ajo përveç kodrës shkëmbore mbi të cilën ishte ngritur, ishte e rrethuar me mure të larta dhe me gardhe telash me gjëmba. Brenda ishin bërë llogore dhe disa pika mbrojtjeje me betonarme.

Sulmi për marrjen e Kalasë së Kaninës filloi më 11 qershor 1920. Lufta u ndez e rreptë. Rreth kalasë shikohej tym dhe flakë. Thirrjet e luftëtarëve shqiptarë në sulm gërshetoheshin me krismat e gjyleve, të predhave dhe të pushkëve. Bo-

¹ Në Kalanë e Kaninës, sipas planit të luftës të Komitetit të Mbrojtjes Kombëtare, ishte caktuar një numër i madh çetash, pasi ajo ishte një vend strategjik me shumë rëndësi. Çlirimi i kësaj kështjelle do të ishte shkatërrimi i forcave italiane në Vlorë.

mbardimet e rënda në fshatin e Kaninës u pasqyruan edhe në këngët popullore:

«Qaj o Vlorë dhe Sazan,
I shkreti Pashaliman,
Me vapor u bë duman,
Kanina u bë viran,
Me paçavure me zjarr».

Topi i kryengritësve shkatërroi disa pozicione të italianëve si dhe një prozhektor¹. Lufta për marrjen e Kalasë së Kaninës u zhvillua me ndërprerje. Në kohën kur në kala vazhdonte sulmi, çetat e Tërbaçit dhe ajo e Bratajt sulmuan një repart italian, që ishte vendosur në Jonufër, i cili kishte për detyrë të godiste forcat tona kryengritëse nga prapa shpinës. Sulmi u bë i rrufeshëm. Jonufri u mor brenda disa orëve nga luftëtarët e këtyre çetave.

Më 18 qershor artileria e Kalasë së Kaninës dhe ajo e anijeve luftarake goditën vullnetarët e vendosur në malin e Shashicës. Repartet italiane, me një fuqi prej 300 vetash, kundërsulmuan Qafën e Pusit. Këtu armiqtë u goditën nga çetat e Tragjasit, të Dukatit e të Radhimës. Lufta zgjati 4 orë. Armiqtë u thyen, duke lënë 84 të vrarë.

Më 19 qershor kundërsulmi u zhvillua duke u mbështetur nga tri batalione arditësh, një batalion alpin i brigadës «Piacenza» dhe tri sekSIONE të artilerisë malore. Po më 19 qershor reparti 20 dhe 22 i këmbësonisë me një batalion të brigadës «Piacenza» lëviznin nga Kanina në drejtim të majës së Shturos, kurse një repart tjetër rrinte në gatishmëri në rezervë. Qëllimi i këtij kundërsulmi me forca të mëdha ushtarake, të

¹ AMH, VI, D. 36.

përforcuara me artileri, ishte që të godisnin forcat kryengritëse në malin e Shashicës dhe topin e kryengritësve në Shashicë, i cili u sillte shumë telashe forcave italiane në Kalanë e Kaninës dhe anijeve luftarake në Skelë. Mirëpo topi ishte i mbrojtur nga forcat vullnetare të çetës së Tërbaçit, si dhe nga forca të tjera vullnetare.

Pas datës 19 qershor lufta për marrjen e Kalasë së Kaninës u zhvillua e ashpër. Të ashpër qenë veçanërisht përpjekjet për të kaluar muret e kalasë dhe gardhet e larta të telave me gjemba. Luftëtarët u hodhën mbi ushtarët italianë.

Shpresë humbur për fitoren, armiqtë filluan ta bombardojnë Kaninën nga toka, nga deti dhe nga ajri. Nga këto bombardime barbare u dogjën krejtësisht shtëpitë e lagjes «Karahysaj», e cila ishte kufi me kalanë. Gjithashtu u dogj dhe u shkatërrua pjesa më e madhe e shtëpive të lagjes «Madhaj» dhe «Hoxhallaj». Gjatë luftimeve ranë në fushën e nderit mjaft dëshmorë, të cilëve populli u ngriti këngë:

*«Atje shumë djem u vranë,
Shakua me Shaip Hasanë,
Azbi Fejzua deli djalë,
Islam Shanua me Hakanë,
Yzeiri rrënjë djalë,
E la t'ëmënë në shkallë,
Hysua me Mustafanë,
Gji për gji e dhanë xhanë.»*

Në këtë luftë të përgjakshme, në një terren shumë të vështirë, ra dëshmori trim i Bolenës, Sino Micoli, që kishte ardhur nga SHBA në ndihmë të vëllezërve të tij, duke luftuar me trimëri të

pashoqe. Heroizmi i tij dhe i shokëve mbeti i gjallë dhe i freskët në këngët labe.

Si luanë luftuan edhe gumenicasit. Nga gjiri i tyre dha jetën trimi Dano Çano. Heroizëm të rrallë dhe të pashoq treguan edhe bijtë e Bratit, që luftuan në shërbim të atdheut. Në luftën për çlirimin e Kalasë së Kaninës prej tyre ranë heroikisht Mahmut Xhaferi e Tare Hadëri. Kështu u vaditën me gjakun e bijve të Labërisë themelet e mureve të Kalasë së Kaninës.

SHKURTIM I BILLETARIT SHKURTAR
12 KORRIK 1930


...shokëve mbeti i gjallë dhe i freskët në këngët labe.
...Si luanë luftuan edhe gumenicasit. Nga gjiri i tyre dha jetën trimi Dano Çano. Heroizëm të rrallë dhe të pashoq treguan edhe bijtë e Bratit, që luftuan në shërbim të atdheut. Në luftën për çlirimin e Kalasë së Kaninës prej tyre ranë heroikisht Mahmut Xhaferi e Tare Hadëri. Kështu u vaditën me gjakun e bijve të Labërisë themelet e mureve të Kalasë së Kaninës.

SULMI I RI I LUFTËTARËVE SHQIPTARË I 22 KORRIKUT 1920

Komiteti «Mbrotjtja kombëtare» në Vlorë mori të gjitha masat për përgatitjen e një sulmi të ri që do ta detyronte qeverinë italiane të nënshkruante aktin e kapitullimit.

Çetat vullnetare u vendosën po në ato pozicione që kishin edhe në sulmin e parë. Komiteti «Mbrotjtja kombëtare», me qëllim që t'i bënte ballë çdo kundërsulmi të befasishëm ose ndonjë krahëmarrjeje nga ana e armikut, kishte përqendruar edhe forca rezervë. Një grup tjetër vullnetarësh ishte caktuar të luftonte në prapavijë të armikut.

Sulmi i ri filloi më 22 korrik 1920. Vullnetarët po i afroreshin shtëpive të para të qytetit. Para këtij sulmi të rrufeshëm armiqtë, megjithëse të shumtë në numër dhe të armatosur gjer në dhëmbë, u detyruan të tërhiqeshin. Por në të gdhirë italianët filluan të bombardonin nga deti, nga toka, nga ajri. I gjithë vendi nga Babica në Sherishtë ishte në flakë. Edhe në këtë



Selam Musai dhe luftëtarë të tjerë kalojnë telat me gjëmba (Pllakat)



Mjetet me të cilat luftëtarët shqiptarë prenë telat me gjemba

sulm vullnetarët shqiptarë treguan akte heroizmi të rralla. Nga tanët në këto sulme u vranë 150 veta; ndërsa armiku pati të vrarë dhe shumë të plagosur: u zunë 60 mitraloza, shumë armë dhe municione¹.

Pas sulmit të 22 korrikut kufiri në qytetin e Vlorës fillonte nga Kuzbabaja (sot bar-lulish-te «1 Maj»), te Xhamija e Plumbit (që është sot monument kulture), që kalonte përmes lagjes «Varosh» dhe dilte në det. Anën veriore të qytetit e kishin luftëtarët vullnetarë shqiptarë, kurse anën jugore, d.m.th. skelën, e kishin italianët.

Ky sulm i furishëm e detyroi komandën e pushtimit italian dhe qeverinë e Romës të pranojnë kapitullimin përpara forcave kryengritëse shqiptare.

¹ 1 A.M.H. VI. D. 38, 42, 48, gazeta «Koha» Korçë, 24 korrik 1920.

NËN DIKTATIN E GRYKËS SË PUSHKËS

Mundja me turp e ushtrive italiane në fazën e parë të luftimeve, fitoret e shqiptarëve në sulmin e 11 qershorit për çlirimin e qytetit të Vlorës, dështimi i kundërofensivës së 18 qershorit si dhe sulmi i 22 korrikut, u dha të kuptojë plotësisht pushtuesve italianë se me ato forca që kishin në Vlorë, jo vetëm që nuk mund ta rivendosnin gjendjen, por ishte e pamundur që të mbanin edhe pozicionet që kishin në duart e tyre.

Në këto rrethana e në kushte shumë të rënda për pushtuesit, qeveria e Romës u detyrua ta rishikonte qëndrimin e saj ndaj problemit shqiptar dhe krejtësisht ndaj çështjes së Vlorës. Tashmë për atë u bë e qartë se nuk kishte asnjë rrugë, asnjë perspektivë për qëndrimin e ushtrive italiane në Vlorë, se populli shqiptar ishte i vendosur t'i hidhte ato në det.

Këto fitore shpunë në bisedimet italo-shqiptare, të cilat nuk u zhvilluan nga dëshira e mirë e pushtuesve italianë, por ishte forca e ar-

mëve, kryengritja popullore shqiptare që i detyroi ushtritë italiane të kapitullojnë me turp dhe bisedimet italo-shqiptare të përfundojnë nën diktatin e grykës së pushkës, deri në pranimin e tërheqjes nga Vlora dhe në dorëzimin e qytetit forcave kryengritëse shqiptare.

Kryengritja e armatosur e Luftës së Vlorës pati disa veçori specifike. Një nga këto ishte përgatitja e kryengritjes me shpejtësi, duke ruajtur fshehtësinë e saj. Lufta u zhvillua në befasia dhe kryesisht natën; ajo u shoqërua me të papritura që e demoralizuan dhe e dobësuan aftësinë mbrojtëse të ushtrisë pushtuese për qëndresën e mëtejshme.

Një karakteristikë tjetër e veçantë e Luftës së Vlorës ishte organizimi ushtarak i popullit në bazë fshati dhe krahine, që është dëshmia më e qartë dhe që flet mbi forcën e pamatshme të një populli, sado i vogël qoftë ai, kur mbështetet në forcat e veta. Në Luftën e Vlorës fshatarësia përbënte forcën goditëse kryesore. Angazhimi i përgjithshëm i masave popullore dhe në radhë të parë i fshatarësisë atdhetare, përcaktoi karakterin popullor të Luftës së Vlorës, në të cilën morën pjesë burra e gra, pleq e të rinj. Fronti dhe prapavija ishin një.

Komanda ushtarake e pushtimit të Vlorës dhe shumë ushtarakë të tjerë, disfatën e tyre u munduan ta përlijin me një «epërsi numerike» të kryengritësve, që nuk përputhej me realitetin. Në fillim të qershorit në të gjithë vendin pushtuesit italianë kishin rreth 20 000 veta. Në Vlorë, në Sarandë e në Tepelenë vepronin Divizioni i 36-të i Këmbësisë me një efektiv prej 14.000 vetash. Në sektorët e tjerë të Bregdetit vepronte Divizioni i 13-të i Këmbësisë me një efektiv prej 6 000 vetash. Forcat kryengritëse

shqiptare, që luftonin për çlirimin e Vlorës, arrinin deri në 6 000 veta. Kështu që raporti i forcave ishte 2,3 me 1, në favor të armikut.

Në fazën e dytë të Luftës së Vlorës u intensifikua ndihmesa e qyteteve dhe e krahinave të ndryshme të vendit, në shumë drejtime. U bënë më shumë demonstrata, mitingje, protesta drejtuar pushtuesve italianë dhe Fuqive të Mëdha imperialiste. Ndihma ka qenë edhe në forca njerëzore, me armë, me municione, me ushqime, me veshmbathje etj.

Lufta e Vlorës u bë pjesë përbërëse e lëvizjes kombëtare shqiptare. Udhëheqja e saj bëri një organizim të centralizuar dhe të studiuar me kujdes. Qendra e drejtimit të veprimtarisë politike shqiptare ishte qeveria e dalë nga Kongresi i Lushnjës, që bashkërendoi veprimtarinë politike dhe ushtarake me Komitetin e Mbrojtjes Kombëtare të Vlorës. Lidhje patën edhe Komitetet e Mbrojtjes Kombëtare, që u krijuan në qytete e në krahina të ndryshme të Shqipërisë, të cilat organizuan tërë veprimtarinë për mobilizimin e popullit.

Kongresi i Lushnjës, dhe në vijim të zbatimit të vendimeve të tij — Kuvendi i Barçallas, ishin pjellë e vrullit luftarak dhe e vendosmërisë së popullit shqiptar për liri e pavarësi. Bashkimi ishte vepër e masave të popullit, që duke u shndërruar në një forcë moralo-politike dhe ushtarake, bëri të mundur fitoren mbi pushtuesin italian.

SOLIDARITET DHE NDIHMË VËLLAZËRORE

Kolonitë shqiptare në emigracion u solidarizuan me luftën çlirimtare të Vlorës. Nga radhët e atdhetarëve shqiptarë, që punonin në SHBA, u nisën vullnetarë. Punëtorët shqiptarë, që punonin në SHBA, në një apel të botuar, më 18 qershor 1920, në «Avanti», organ i Partisë Socialiste Italiane, i bënë thirrje proletariatit italian t'i jepte fund luftës në Shqipëri. «Historia njerëzore, përfundonte apeli, nuk mund ta falë kurrë një sulm kaq brutal të një fuqie të madhe kundër një populli të vogël dhe pa mbrojtje».¹ Konsulli italian në Nju-Jork u urdhërua që të mos u jepte lejkalimi shqiptarëve, që donin të shkonin në Shqipëri.² Por këto masa jo vetëm që nuk e ndaluan ardhjen e atdhetarëve, por përkundrazi e forcuan edhe më shumë bindjen për t'u gjendur pranë vatanit.

1 Gazeta «Avanti», 18 qershor 1920.

2 Revista «Përparimi», Nju-Jork, f. 1, viti 1920.

Vullnetarët shqiptarë, që erdhën nga SHBA, më 27 korrik 1920, të shoqëruar nga banda «Vatra», me porosi të qeverisë së Tiranës, u nisën nga Korça për në Vlorë.¹ Edhe kolonitë e tjera të mërgimit u solidarizuan gjithashtu me Luftën e Vlorës. Studentët shqiptarë të Zvicrës i drejtuan një apel popullit italian dhe një tjetër presidentit të Konferencës së Paqes në Paris. Ja ç'thuhet midis të tjerash në këtë apel: «Ne përsërisim para botës se liria jonë ka për të na u grabitur veç atëherë kur atdheu ynë ka m'u ba një vorrezë e gjanë e anmiqve».²

Me luftën çlirimtare të Vlorës u bashkuan gjithë shqiptarët jashtë atdheut: të Italisë, të Amerikës, të Francës, të Rumanisë, të Bullgarisë, të Austrisë, të Turqisë etj.³ Komiteti Qendror i Lidhjes Kombëtare Shqiptare «Skënderbeu» në Itali u drejtoi thirrje kolonive shqiptare për të mbrojtur të drejtat e kombit shqiptar pas Luftës së Parë Botërore në Konferencën e Paqes.

Solidariteti dhe ndihma që dhanë atdhetarët shqiptarë të kolonive ishin faktorë të jashtëm që ndikuan në fitoren e Luftës së Vlorës. Ata u bashkuan me vëllezërit e tyre shqiptarë dhe luftuan krah për krah derisa i hodhën armiqtë në det, deri në çlirimin e vendit nga pushtuesit italianë.

1 Revista «Studime historike», Tiranë, nr. 2, viti 1964, fq. 225-229.

2 AQH i RPSSH, FL, VI, 1920, nr. 51262, 512272.

3 AQH i RPSSH, D. 1, Dok. nr. 47, origjinal.

PËRKRAHJE E FUQISHME E PROLETARIATIT ITALIAN DHE OPINIONIT PUBLIK NDËRKOMBËTAR

Pas sulmit të 5 qershorit dhe veçanërisht pas sulmit të 11 qershorit 1920, gjatë të cilit shqiptarët rrezikuan seriozisht fatin e ushtrisë italiane në Vlorë, pozitat e qeverisë së Romës lidhur me pretendimet e saj në Shqipëri, u tronditën edhe më tepër. Në qytetet kryesore të Italisë, proletariati italian kaloi nga protestat e thjeshta në greva dhe demonstrata. Luftën e tij, që drejtohej kundër ngritjes së çmimeve të bukës, proletariati italian e lidhi me luftën për ta detyruar qeverinë e Romës që t'i jepte fund Luftës së Vlorës, duke tërhequr trupat nga Shqipëria. Në portet e Adriatikut (në Trieste, në Ankona, në Bari, në Brindisi) u afishuan thirrjet e Partisë Socialiste Italiane, të cilat i ftonin ushtarët që të mos pranoin të niseshin për në Shqipëri.¹ Një manifestim i tillë në Trieste, më

¹ Gazeta «Drita», 10.VII.1920.

12 qershor 1920, përfundoi me një përlëshje të përgjakshme¹. Po atë ditë grupi i deputetëve socialistë i paraqiti për miratim Parlamentit Italian një rezolucion, me anën e të cilit kërkohet largimi i trupave italianë nga Vlora, por ky rezolucion nuk u pranua nga shumica e deputetëve, që mbronin interesat e qarqeve imperialiste.

Sukseset e korrura në fazën e parë të luftimeve në Vlorë e tronditën nga themelet qeverinë e Nitit. Këto si dhe fitorja e luftëtarëve vullnetarë shqiptarë e datës 11 qershor në qytetin e Vlorës, krijuan të çara të thella në atë qeveri. Më 13 qershor 1920 gjendja e brendshme politike e Italisë u acarua në kulm. Pikërisht në këtë datë vendin e qeverisë së Nitit e zuri ajo e kryesuar nga Xhovani Xholiti.²

Edhe qeveria e re u orvat në fillim të shtypë luftën e popullit shqiptar me anën e forcës, por kjo rrugë dështoi.

Qëndrimi i Xh. Xholitit në pozitat e imperialistëve të qeverisë së mëparshme italiane e nderi edhe më tepër zjarrin e protestave në Shqipëri. Në qytetet e vendit u zhvilluan mitingje kundër imperialistëve italianë. Telegrame protestash iu dërguan Romës edhe nga kolonitë shqiptare të mërgimit. Brenda dhe jashtë vendit u miratuan gjithashtu rezolucione që iu drejtuan Konferencës së Paqes, me anën e të cilave shqiptarët solidarizoheshin me kërkesat e luftëtarëve

1 Gazeta «Avanti», 31.VII.1920.

2 Xhovani Xholiti (1842-1928), kryetar i partisë liberale borgjeze dhe disa herë kryeministër i Italisë. Ndihej në organizimin, në armatimin dhe në veprimtarinë e bandave fashiste të Musolinit. Armik i betuar i kombit shqiptar dhe partizan i Traktatit të Fshehtë të Londrës të vitit 1915.

të Vlorës. Gazetat përparimtare italiane dilnin me parulla antiimperialiste si, p.sh., «Nuk duam udhëtime ushtarake në Shqipëri», «Proletariati të jetë vigjilent dhe gati kundër dredhive imperialiste», «Më mirë se një luftë do të na vlejë revolucionari».

Kundërshtimet e proletariatit italian vazhdonin pa ndërprerje. Më 25 qershor 1920, në Romë u zhvillua një miting i madh me temën «Largimi i trupave italianë nga Shqipëria». Në të përfaqësuesit e organizatave shoqërore dhe politike dënuan rëndë politikën kolonizatore të qeverisë imperialiste italiane. «Ne kërkojmë largimin e trupave italianë nga Shqipëria dhe njohjen e së drejtës së popullit shqiptar», u tha nga të gjithë në këtë miting¹. Në qershor 1920 punëtorët e trenave nuk pranuan që të ngarkonin municione, të cilat dërgoheshin kundër popullit shqiptar. Më 26 qershor 1920 repartet e bersalierëve në Ankona nuk pranuan të niseshin për në Shqipëri aq sa edhe u përgjakën me karabinierët.² Me ta u bashkuan edhe masat popullore. Proletariati i Ankonës shpalli grevën e përgjithshme. Shpërtheu një luftë e ashpër barrikadash ndërmjet kryengritësve e demonstruesve nga njëra anë dhe forcave qeveritare nga ana tjetër. Sikurse njoftonte ato ditë shtypi i kohës, «Ankona kaloi nëntë ditë paralize të plotë». Njoftime të tjera bënë të ditur se për 24 orë ai qytet mbeti në duart e kryengritësve, derisa erdhën përforcime për fuqitë qeveritare nga vise të tjera të Italisë. Ngjarja pati rrjedhime të tilla, sa që pati gazeta, të cilat e cilësuan atë si shpallje të «Republikës Sovjetike të Ankonës». Sipas njoftime-

¹ Gazeta «Avanti», 26 qershor 1920.

² Gazeta «Avanti», 27 qershor 1920.

ve të zvogëluara të shtypit italian, ka pasur 24 të vdekur dhe 71 të plagosur. Kjo demonstratë pati karakter të theksuar klasor proletar. Ajo mori përpjesëtime të gjera dhe u zhvillua me parulla politike të mprehta antikapitaliste dhe antiimperialiste. Lëvizja e Ankonës kishte shkaqet e veta të thella shoqërore të brendshme: antagonizmi klasor ndërmjet proletariatit e borgjezisë italiane, gjendja e rëndë politike dhe ekonomike e proletariatit dhe e masave të tjera punonjëse të Italisë, shfrytëzimi i tyre i egër nga ana e kapitalit. Këto ngjarje e veprime u gërshtuan dhe u lidhën edhe me «problemin shqiptar» apo me «krizën shqiptare» të qarqeve drejtuese borgjezo-revizioniste të Romës.¹

Lufta e armatosur antiimperialiste e popullit shqiptar e vitit 1920 u përkrah jo vetëm nga proletariati dhe nga masat e tjera popullore të Italisë, por ajo u prit ngrohtë dhe fitoi simpatinë e qarqeve përparimtare edhe në vende të tjera të botës. Me këtë çështje është marrë opinioni publik përparimtar dhe shtypi i Francës, i Anglisë, i SHBA, i Belgjikës, i Zvicrës, i Jugosllavisë, i Greqisë, i Rumanisë, i Bullgarisë, i Spanjës, i Gjermanisë, i Egjiptit, i Japonisë dhe i vendeve të tjera. Duhet thënë se për një kohë të gjatë qarqet e huaja imperialiste dhe qarqet shoviniste të Ballkanit kishin zhvilluar një fushatë të madhe antishqiptare, aq sa për qëllimet e tyre grabitqare kishin arritur deri atje sa t'i mohonin popullit shqiptar qenien dhe ndërgje-

1 Kongresi i Lushnjës dhe Lufta e Vlorës, Tiranë, 1974. V. Toçi, «Solidariteti i forcave përparimtare të botës në luftën e armatosur antiimperialiste të popullit shqiptar të vitit 1920», f. 210.

gjen e tij kombëtare.¹ Lufta e Vlorës e goditi rëndë këtë fushatë antishqiptare dhe e detyroi opinionin publik të botës të flasë ndryshe dhe jo pa respekt për çështjen shqiptare, duke botuar lajme, informacione e komente të shumta rreth kryengritjes shqiptare për mbrojtjen e të drejtave kombëtare, të lirisë e të sovranitetit, të shkelura nga imperializmi italian.

Më 17 qershor 1920 gazeta franceze «Democratie nouvelle» botoi një artikull ku shprehej me simpati për popullin shqiptar, duke e cilësuar si një popull, të cilin nuk mundën ta nënshtrojnë për shumë shekuj turqit dhe nuk mund të pushtohet e të nënshtrohet lehtë. Populli shqiptar, thoshte gazeta, nuk pranon asnjë lloj kontrolli prej qeverisë italiane. Një gazetë tjetër franceze «La Tribune republicaine», e datës 24 qershor, duke dënuar politikën italiane ndaj Shqipërisë, shkruante ndër të tjera: «Ngjarjet e këtyre 15 ditëve të fundit e kanë nxjerrë këtë vend në planin e parë të preokupimeve evropiane. Këtu veprojnë ambiciet, interesat. Italianët bëjnë një lojë të rrezikshme duke u përpjekur që ta kolonizojnë Shqipërinë».

Nuk mungojnë në gazetatat e asaj kohe edhe konsiderata të tilla se «shqiptarët dhe Shqipëria janë një popull e një vend që meritojnë fizikisht, moralisht dhe intelektualisht independencën e tyre».²

Lufta e armatosur antiimperialiste e popullit shqiptar e vitit 1920 dhe problemi shqiptar, që rridhte prej saj, u trajtuan në shtypin e huaj me tituj nga më të ndryshmit. Kjo nuk ishte një

1 M. Çami, *Lufta çlirimtare antiimperialiste e popullit shqiptar në vitet 1918-1920*, Tiranë, 1969, f. 202.

2 V. Toçi, *Vepër e cituar*, f. 213.

gjë e rastit, por kishte domethënien e vet politike e morale. Me luftën e tij heroike, antiimperialiste dhe çlirimtare populli shqiptar fitoi miq e përkrahës të zjarrtë në shumë vende të botës, në radhë të parë në gjirin e proletariatit edhe të masave popullore. Me këtë luftë ai i detyroi kancelaritë e Fuqive të Mëdha imperialiste të reviziononin «vendimet» dhe «marrëveshjet» e tyre grabitqare për copëtimin e Shqipërisë dhe të ripohonin pavarësinë e saj brenda kufijve politikë të pranuar nga Konferenca e Ambasadorëve në Londër e vitit 1913¹.

Largimi i pushtuesve italianë nga Vlora nuk u prit mirë nga qarqet imperialiste italiane, të cilat e dënuan qeverinë e Romës për marrëveshjen e arritur me qeverinë shqiptare. Musolini e cilësoi marrëveshjen si një katastrofë politike e morale për Italinë, ndërsa të tjerë e cilësuan një grusht të rëndë kundër prestigjit italian në Evropë e në botë.² Pati edhe qarqe që u shprehën si më poshtë: «Zgjidhja e çështjes së ndërlikuar të Vlorës është një zhgënjim i hidhur për kombin italian... Sakrificat e bëra në Shqipëri dhe situata, që na siguronin traktatet, meritojnë një zgjidhje tjetër.»³

Për të qetësuar hysterizmin dhe pakënaqësitë e këtyre qarqeve ndaj disfatës italiane në Shqipëri, ministri i Jashtëm i Italisë bëri një deklaratë në parlament rreth politikës së jashtme të qeverisë. Ai që i detyruar të pohonte se italianët u tërhoqën nga Vlora, sepse nuk mund të qëndronin të sigurtë e të qetë në atë qytet pa provokuar, në të njëjtën kohë, si pakënaqësitë

1 V. Toçi, *Po aty*.

2 «Avanti», 5 gusht 1920.

3 «L'Italia», 5 gusht 1920.

ashtu edhe keqardhjen e popullit shqiptar.¹ Qarqet qeveritare u munduan ta zbusnin efektin e disfatës italiane në Shqipëri me lloj-lloj mënyrash. Për ngjarjet që kishin ndodhur dhe për kryengritjen shqiptare këto qarqe bënë shkaktarë trashëgiminë e trishtueshme e diplomatike të qeverisë pararendëse të Xholitit dhe vështirësitë e brendshme që kalonte vendi.

Dënimi i agresionit imperialist italian në Vlorë nga ana e proletariatit dhe e masave të tjera popullore të Italisë si dhe nga një sërë vendesh të tjera të botës, përkrahja e tyre morale e politike, e rritën më lart hovin dhe gjendjen e brendshme të kryengritësve shqiptarë. Lufta e proletariatit italian dhe e tërë forcave përparimtare të botës nëpërmjet demonstratave, protestave, grevave, thirrjeve e të tjera, ishin faktorët që ndihmuan popullin shqiptar, i cili luftoi duke bërë sakrifica të mëdha, të arrinte më në fund fitoren mbi një armik më të madh në numër dhe në armatime.

1 «Il Tempo», 7 gusht 1920.

PROTOKOLLI I TIRANËS—ÇLIRIMI I VLORËS

Fitoret e kryengritjeve shqiptare e detyruan qeverinë e Romës që të fillonte bisedimet me qeverinë e Tiranës për t'i dhënë fund luftës në Shqipëri. Më 2 korrik 1920, me anijen «Duillon» baron Alioti zbriti në Durrës. Më 4 korrik filluan bisedimet në Tiranë. Deri më 8 korrik ato nuk dhanë ndonjë rezultat. Përfaqësuesi i Italisë synonte që me anën e bisedimeve të zëvendësonte humbjet në fushën ushtarake. Ai kërkonte që lufta të pushonte dhe në të njëjtën kohë trupat italianë të qëndronin në Sazan dhe në Skelën e Vlorës ku të ndërtonin një bazë ushtarake detare për arsye «strategjike» dhe për të «siguruar paqen në Ballkan». Italia kërkonte gjithashtu edhe disa privilegje të veçanta tregtare dhe ekonomike në Shqipëri.

Pala shqiptare i hodhi poshtë propozimet e Aliotit. Populli i kryeqytetit dhe i gjithë Shqipërisë u indinjua kur mësoi kërkesat pushtuese të përfaqësuesve italianë. Më 9 korrik 1920 u zhvillua në Tiranë një miting i madh, ku u shpreh urrejtja kundër pretendimeve italiane.

Mijëra demonstrues me flamurin kombëtar në krye kaluan nëpër rrugët e kryeqytetit, jehonin këngët kombëtare dhe brohoritjet «Rroftë Vlora jonë».

Kur Alioti e pa të pamundur që t'i detyronte palës shqiptare kushtet e imponuara të armëpushimit, vendosi bashkë me demagogjinë edhe shantazhin. Ai u nis për në Drashovicë për të filluar bisedimet me Komitetin e Mbrojtjes Kombëtare dhe po t'ia arrinte qëllimit ta detyronte dhe qeverinë e Tiranës të pranonte kërkesat italiane. Por edhe kjo orvatje dështoi nga qëndrimi i vendosur i anëtarëve të komitetit, të cilët i hodhën poshtë kërkesat e Romës.

Luftëtarët shqiptarë kishin qëndruar prej disa javësh në pozicionet e tyre, në pritje të bisedimeve të Tiranës. Po pas shpalljes së 17 korrikut durimi i tyre mori fund. Komiteti i Mbrojtjes Kombëtare u kërkoi edhe një herë italianëve, më 20 korrik, me anën e qeverisë së Tiranës, një përgjigje përfundimtare, që pritej deri të nesërmen mbi pranimin ose jo të kërkesave shqiptare. Natën, duke u gdhirë 23 korriku, luftëtarët ndërmoren një sulm të fuqishëm dhe pas disa orë luftimesh hynë përsëri në lagjet e jashtme të qytetit.¹

Fitoret e njëpasnjëshme të Luftës së Vlorës dhe presioni i madh i proletariatit italian e detyruan qeverinë italiane që ta thërriste baronin Alioti të kthehej në Itali. Misioni i tij dështoi. Në vend të tij u dërgua konti Manconi, i cili më 29 korrik 1920, erdhi në Tiranë për të përfunduar traktatin në bazë të kërkesave të palës shqiptare. Borgjezia italiane u detyrua të pranonte dështimin e plotë që pësoi nga populli

1. Historia e Shqipërisë, vëll. 3, Tiranë 1984, f. 232.

shqiptar. Duke e krahasuar këtë humbje me atë që pësoi Italia në Kaporeto¹ prej ushtrisë austro-hungareze në Luftën e Parë Botërore, përfaqësuesi i rretheve më reaksionare borgjeze italiane, Benito Musolini, shkruante në korrik 1920: «Kaporetoja» shqiptare është shumë më e rëndë se tjetra, që u zhvillua midis Izoncos e Pieves. Atëherë humbëm pozita materiale, njerëz dhe dy krahina, por nuk humbëm vullnetin për të rifilluar dhe për të rifituar. Këtë herë disfata jonë është e rendit moral dhe tanimë diplomatikisht e kemi vulosur si një fakt të pranuar dhe të kryer. Pak mijëra shqiptarë, pa artileri na hodhën me furi në Vlorë dhe, për të shmangur hedhjen në det, hapëm bisedime pa ndonjë rezultat»².

Bisedimet shqiptaro-italiane përfunduan më 2 gusht 1920, me nënshkrimin e një protokolli, i cili përmbante 8 pika, dhe konkretisht:

1. Çështjet që u interesonin të dyja vendeve do të zgjidheshin nga një komision i përbërë prej italianësh dhe shqiptarësh.

2. Qeveria italiane do të tërhiqte trupat e saj nga Vlora dhe nga pjesa tjetër e Shqipërisë, me përjashtim të ishullit të Sazanit. Afati i tërheqjes dhe hollësiat e tjera do të caktoheshin nga një komision italo-shqiptar.

3. Derisa të largoheshin trupat italianë luftëtarët shqiptarë do të tërhiqeshin në lindje të lumit Shushicë. Vendi midis këtij lumi dhe detit

1. Kaporeto — komunë e krahinës së Goricias në Italinë Verilindore, ku më 24 tetor 1917, ushtritë italiane, në përpjekje me ushtrinë austro-hungareze, pësuan një disfatë të rëndë.

2. Historia e Shqipërisë, vëll. 3, Tiranë, 1984, fq. 232-233.

do të konsiderohej zonë neutrale. Qeveria shqiptare mund të dërgonte funksionarë me reparte xhandarmërie për të marrë në dorëzim administratën e qytetit dhe të rrethit të Vlorës 15 ditë mbasi të kishte filluar riadhesimi i trupave italianë. Qetësia në zonën neutrale do të mbahej nga trupa të xhandarmërisë shqiptare.

4. Trupat italianë gjatë periudhës së nisjes do të kishin në dispozicion Skelën e Vlorës, duke mos penguar tregtinë dhe lëvizjen e popullsisë civile.

5. Kjo pikë bënte fjalë për një komision të posaçëm italo-shqiptar që do të merrte vendime për ruajtjen dhe për respektimin e ndërtesave dhe të objekteve të tjera, pronë e qeverisë italiane, të cilat do t'i caktoheshin qeverisë shqiptare dhe do t'i llogariteshin për dëmet e shkaktuara.

6. Të dyja palët do të bënin një amnisti.

7. Të gjithë shtetasit italianë dhe shqiptarë të arrestuar liroheshin brenda afatit të zbrazjes së Vlorës.

8. Ky protokoll do të mbahej i fshehtë.¹

Nënshkrimi i protokollit të Tiranës dhe lajmi i largimit të trupave italianë nga Vlora ngjallën një entuziazëm të madh në të gjithë Shqipërinë. Luftëtarët trima brohoritën fitoren e arritur, që solli bashkimin e Vlorës me atdheun. Menjëherë pas nënshkrimit të protokollit ata iu bindën urdhrave të qeverisë për të zbratur zonën neutrale dhe u tërhoqën menjëherë në lindje të lumit Shushicë. Kjo ishte një fitore e madhe, që u arrit me luftë heroike në sajë të solidita-

¹ AQH i RPSSH, FLVI, D. 1, Dok. nr. 39, origjinal; «Dokumente e materiale historike nga lufta e popullit shqiptar për liri e demokraci 1917-1941», Tiranë, 1959 fq. 77-78.

ritetit dhe të ndihmës aktive të të gjitha krahinave të Shqipërisë, të të gjithë atdhetarëve shqiptarë jashtë atdheut, të cilët e ndihmuan këtë luftë.

Komisioni i përzier italo-shqiptar u mblodh më 8 gusht 1920. Kryengritësit respektuan protokollin duke zbrazur zonën neutrale. Më 17 gusht 1920 italianët të përqendruar në Skelë filluan të largohen.¹ Nga Tirana erdhi xhandarmëria dhe mori në dorëzim qytetin. Më 28 gusht u liruan mbi 1700 robër, ushtarë dhe oficerë italianë, të cilët mbaheshin në kampin e robërve të Vajzës, kurse italianët liruan 1400 të internuar vlonjatë, që i mbanin në ishullin e Sazanit. Usharakët që morën pjesë në luftën kundër popullit shqiptar shkuan të mundur në Itali.

Më 2 shtator 1920, 15 ditë pasi kishte filluar largimi i trupave italianë, Vlora dhe Skela u zbrazën. Prefekti i emëruar nga qeveria dhe nëpunësit morën në dorëzim administratën e qytetit. Për të pritur luftëtarët në Vlorë u krijua një komision, i cili grumbulloi nga qytetarët 63 000 franga ari.²

Më 3 shtator 1920 u festua me madhësi dita e çlirimit të Vlorës nga pushtuesit italianë. Vlora ishte zbukuruar më së miri. Nga të dyja anët e rrugëve kryesore ishin vendosur shtylla të veshura me dafina. Në mes të Sheshit të Flamurit ngriheshin dy harqe të bashkuara me rripa kuq e zi dhe sipër tyre valëviteshin flamuj kombëtarë. Në mes të harqeve ishin dy podiume: njëri për muzikantët e bandës «Vatra» të shqiptarëve të Amerikës dhe të bandës «Afërdita» të

1 Gazeta «Drita», 21 gusht 1920.

2 Kristo Frashëri, «Buletin i shkencave shoqërore», nr. 3, Tiranë, 1954, f. 23.

Elbasanit, dhe tjetri për oratorët. Ishte ngritur gjithashtu edhe një shtyllë përkujtimore e veshur me rripa kuq e zi për nder të dëshmorëve që ranë në luftë.

I gjithë populli, i madh e i vogël, doli herët në rrugët e qytetit për të pritur luftëtarët e lirisë. Në orën 10.00 u duk flamuri kombëtar në krye të anëtarëve të Komitetit të Mbrojtjes Kombëtare, që ishin mbi kuaj, pastaj banda muzikore e Elbasanit e pasuar nga kaloria e komandantëve të çetave e, pas tyre, 5000 burra të armatosur. Ushtria çlirimtare, që përbënte 7 kolona të krahinave të ndryshme, të cilat kishin marrë pjesë në luftë, hyri në qytet.¹ Sheshi i Flamurit u mbush plot e përplot. Në tribunë zunë vend anëtarët e Komitetit të Mbrojtjes Kombëtare. Ministri Spiro G. Koleka përshëndeti në emër të qeverisë luftëtarët dhe popullin e Vlorës.² Në fjalimin e tij, midis të tjerash, tha: «Në këto fusha e kodra u los fati jo vetëm i Vlorës, po mundem të them i gjithë Shqipërisë» dhe më poshtë: «...Vdekja e Shqipërisë ishte në urdhrin e ditës, megjithëkëtë shqiptarët nuk u dëshpëruan. I folën dhe i thanë botës së qytetëruar nga Lushnja: Përpara se të humbë kështu Shqipëria, me pushkë në dorë le të vdesë trimëria» dhe shtoi: «...Kjo heroizëm kaq e madhe, u përket juve dhe udhëheqësve tuaj. Juve u përket kurorëzimi i nderit, juve u përket kurora e dafintë. Ushtarë! Historia na tregon se luftën nuk e fitojnë ata që kanë shumë armë, topa dhe vegla të luftës, por e fitojnë ata që kanë vendosur të vdesin për atdhe».³

1 «Mbrojtja Kombëtare», 14 tetor 1920.

2 Gazeta «Drita», 11.IX.1920.

3 Gazeta «Drita», 11.IX.1920.

«Në mes duartrokitjeve të zjarra e mori fjalën edhe kryetari i Komitetit të Mbrojtjes Kombëtare Osman Haxhia. Pastaj të pranishmit shkuan te ish-prefektura, ku u ngrit flamuri. Pas ceremonisë filloi kënga e vallja. Në orën 19,30 populli me bandën e shoqërisë «Vatra» në krye qëndroi përpara shtyllës së dëshmorëve, ku foli Jani Minga. Të nesërmen, më 4 shtator 1920, u vizitua varri i plakut të kombit Ismail Qemali në Kaninë.¹

¹ Gazeta «Drita», 11.IX.1920.

FAKTORËT E FITORES DHE RËNDËSIA E SAJ

Lufta e Vlorës e vitit 1920 ishte luftë e tërë popullit shqiptar, që me heroizmin e pashe-mbullt të luftëtarëve vullnetarë, të vegjëlisë, si-domos të fshatarësisë së Labërisë, krijoi tërë rrethanat dhe kushtet historike, politike dhe ushtarake për fitoren e saj mbi pushtuesit imperialistë italianë. Fitorja e Luftës në Vlorë u arrit nga një sërë faktorësh, që ndihmuan krye-sisht në triumfin e popullit shqiptar mbi pushtuesit italianë në vitin 1920.

Lufta që zhvillonte populli shqiptar kundër pushtuesve italianë ishte e drejtë, luftë për çli-rimin e vendit, për të qenë i lirë e i pavarur.

Karakteri i drejtë i saj ka qenë burim fry-mëzimi për popullin tonë, për mobilizimin e gji-thë forcave atdhetare e revolucionare. Pikërisht për këtë ajo fitoi simpatinë dhe mbështetjen e forcave revolucionare dhe të popujve përparim-tarë të botës.

Faktori moralo-politik ishte një nga faktorët kryesorë që përcaktoi fatin e fitores. Uniteti i me-

ndimit dhe i veprimit i forcave kryengritëse shqiptare dhe nga ana tjetër i Komitetit të Mbrojtjes Kombëtare si dhe i qeverisë së Tiranës, që së bashku zbatuan dhe vunë në jetë vendimet e Kongresit të Lushnjës, përbënin një faktor objektiv të fitores.

Uniteti moralo-politik i popullit tonë në këtë luftë lidhej me faktin që në atë kohë kishte dalë në plan të parë kontradikta midis pushtuesve imperialistë italianë dhe popullit shqiptar, e cila arriti kulmin e ashpërsimit menjëherë pas mbarimit të Luftës së Parë Botërore, kur synimet skllavëruese të pushtuesve italianë u bënë më kërcënuese, gjë që e çoi popullin shqiptar në luftën e armatosur për çlirimin e vendit.

Ky unitet e kishte burimin jo vetëm në luftën e drejtë, por edhe në veitë luftarake të popullit tonë, që e kanë karakterizuar atë në shekuj gjatë përlëshjeve me armiqtë. Atdhetarizmi i lartë, urrejtja e madhe ndaj armikut, vendosmëria për të luftuar me armë në dorë deri në fitoren përfundimtare, besimi në forcat e veta, shpirti i sakrificës deri në dhënien e jetës për çlirimin e atdheut, heroizmi masiv popullor, të gjitha këto shpunë në bashkimin e vullnetit të kombit shqiptar për çlirimin e Vlorës dhe bashkë me të, të të gjithë Shqipërisë. Morali i ushtrisë vullnetare shqiptare ishte i lartë nga fillimi deri në mbarim të saj, ndërsa e kundërta ndodhte në ushtrinë armike, pasi ajo luftonte për pushtimin, për skllavërimin dhe për shfrytëzimin e popullit shqiptar.


Lufta e Vlorës nuk ishte një «luftë rebelsh», si e paraqiste propaganda e pushtuesve italianë, por e organizuar nga atdhetarët, e mbë-



Hyrje e luftëtarëve në Vlorën e çliruar

Pamje nga mitingu i Vlorës i 3 shtatorit 1920





Monumenti i Drashovicës ku përkujtohen dy epopetë e mëdha,
e vitit 1920 dhe e vitit 1943

shtetur në traditat e luftës popullore dhe e drejtuar nga njerëz me njohuri ushtarake.

Një faktor tjetër që ndihmoi në këtë fitore, ishte terreni ynë i thyer malor dhe pjesërisht kodrinor si dhe hartimi e zbatimi i strategjisë e i taktikës ushtarake, në përputhje me kushtet e vendit si dhe me formën e organizimit të çetave vullnetare, duke ua përshtatur forcave të mëdha luftarake italiane, të pajisura me armatimet moderne të kohës.

Në fazën e parë lufta u zhvillua krejtësisht në terrenin malor, terren ky shumë i përshtatshëm për luftëtarët tanë të organizuar në çeta dhe i pafavorshëm për armikun.

Në ndihmë të luftës çlirimtare të Vlorës u ngritën në këmbë edhe kolonitë shqiptare, të cilat nuk u pajtuan me pushtimin italian në Vlorë. Me veprimet e tyre revolucionare ato demaskuan qëllimet pushtuese imperialiste ndaj vendit tonë dhe nga ana tjetër, i bënë thirrje proletariatit italian për t'u ngritur kundër qeverisë së Romës, me qëllim që ta detyronin atë të tërhiqte trupat pushtuese nga Shqipëria.

Lufta e armatosur antiimperialiste e Vlorës u përkrah moralisht e politikisht jo vetëm nga proletariati dhe nga masat e tjera popullore të Italisë, por edhe nga proletariati dhe nga masat popullore të vendeve të tjera të Evropës dhe të botës.

Qëllimi kryesor ishte të çlirohej Vlora nga pushtuesit imperialistë italianë dhe të bashkohej me tokën - mëmë. Kjo luftë luajti rol me rëndësi për zgjidhjen e fatit të të gjithë Shqipërisë. Asgjësimi i pushtuesve italianë shkatërroi edhe planet e shteteve të tjera shoviniste, që donin ta copëtonin Shqipërinë.

Populli në Luftën e Vlorës vuri në jetë ve-

ndimet historike të Kongresit të Lushnjës, për sigurimin e plotë të pavarësisë e të tërësisë tokësore të vendit. Dhe, siç ka thënë shoku Enver Hoxha: «Kongresi i Lushnjës hodhi poshtë me forcë Traktatin e Fshehtë të Londrës të denoncuar nga Lenini i madh, ndërsa fshatarësia revolucionare e Vlorës, me heronj të tillë si Selam Musain, i hodhi okupatorët italianë në det».¹

Fitorja e Luftës së Vlorës kundër pushtuesve imperialistë italianë, më 1920 përbënin një gur themeltar në konsolidimin e pavarësisë politike në Shqipëri dhe njëkohësisht faktorin vendimtar, që ndaloi copëtimin e vendit pas Luftës së Parë Botërore.

Gjaku i derdhur në këtë luftë i forcoi themelet e lirisë e të pavarësisë. Lufta e Vlorës i çoi më tej traditat luftarake e atdhetare të popullit tonë dhe hyri në historinë e popullit shqiptar si një epike e trimërisë legjendare të luftëtarëve dhe e gjakut të 400 e ca dëshmorëve. Heroizmi masiv popullor, besimi në fitoren, urrejtja e një populli që e kishte aq të shtrenjtë çështjen e lirisë, u materializuan me fitoren mbi armiqtë.

Kjo epike u bë burim frymëzimi për brezat e ardhshëm. Ajo u gdhend mirë në kujtesën e popullit dhe në kohët e vështira të regjimeve antipopullore e sidomos të pushtimit të huaj. Traditat luftarake të Luftës së Vlorës, më 1920, u përsëritën me një shkëlqim më të madh në Luftën Antifashiste Nacionalçlirimtare që bëri populli ynë nën udhëheqjen e Partisë të drejtuar nga themeluesi i saj shoku Enver Hoxha. Për të ruajtur këto tradita luftarake në shenjë kujtimi e nderimi dëjta nga çetat partizane morën

1 Enver Hoxha, Vepra, vëll. 24, fq. 16

emrat e dëshmorëve dhe të luftëtarëve të vitit 1920, si çeta partizane «Halim Rakipi», «Zigur Lelo», «Hodo Zeqiri», «Halim Xhelo», «Sali Murati», «Kanan Maze» etj.

PPSH, trashëgimtarja besnike e traditave atdhetare të popullit tonë, i ngriti ato në një shkallë akoma më të lartë nën dritën e mark-sizëm-leninizmit, duke i përdorur si armë të fuqishme për të edukuar brezin e ri dhe gjithë popullin në Luftën për ndërtimin e jetës së re socialiste dhe për mbrojtjen e fitoreve të revolucionit tonë popullor. Ato do t'u ndriçojnë rru-gën edhe brezave që do të vijnë.

PERMBAJTJA

Parathënie	5
Pushtimi i Vlorës nga imperializmi italian më 1914	11
Vitet 1915-1919	14
Rritja e rezistencës së popullit shqiptar	19
Demonstrata antiimperialiste e Vlorës	26
Në pragun e Luftës së Vlorës	32
Kuvendi i Barçallasë dhe mbledhja e Beunit	44
Shkatërrimi i postëkomandave italiane	49

Faza e parë e luftimeve 5-10 qershor 1920

Çlirimi i Kotës	52
Çlirimi i Drashovicës, i Gjormit, i Llogarasë	59
Çlirimi i Matohasanajt dhe i Tepelenës	64

Faza e dytë e luftimeve

Lufta për çlirimin e Vlorës	69
Dështimi i kundërofensivës armike	80
Çlirimi i Kaninës	85
Sulmi i ri i luftëtarëve shqiptarë i 22 korrikut 1920	90
Nën diktatin e grykës së pushkës	92
Solidaritët dhe ndihmë vëllazërore	95
Përkrahje e fuqishme e proletariatit italian dhe opinionit publik ndërkombëtar	97
Protokolli i Tiranës. Çlirimi i Vlorës	104
Faktorët e fitores dhe rëndësia e saj	111

Shehu, N.
Lufta antiimperialiste e Vlorës e vitit
1920. [Red.: J. Toçka], T., «8 Nëntori»,
1986.

...f.

(B.m.) dhe

(B.v.): 949.65.036.2

Sh 29

Tirazhi 1500 kopje Format 49,8x78,2/16 Stash: 2204-82

Shtypur: Kombinati Poligrafik
Shtypshkronja «8 Nëntori», Tiranë, 1986